RAPORTI PËRFUNDIMTAR
MBI AUDITIM FINANCIAR
BASHKIA DIBËR

Tiranë, shtator 2026

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale
AK	Autoritet Kontraktor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
UP	Urdhër Prokurimi
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

		PËRMBAJTJA	Faqe
I		**PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4-11**
	1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	4-5
	2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-9
	3	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	10-11
II.		**HYRJA**	**11-16**
	1	Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	11-11
	2	Identifikimi i çështjes	11-12
	3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12-13
	4	Përgjegjësitë e audituesve	13-13
	5	Kriteret e vlerësimit	13-14
	6	Standardet e auditimit	14-15
	7	Metodat e auditimit	15-16
	8	Dokumentimi i auditimit	14-15
III.		**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**15-79**
	1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	15-16
	2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	16-88
	2.1.1.	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	16-27
	2.1.2.	Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm	27-32
	2.2.	Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	32-39
	2.2.5.	Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.	39-47
	2.3.	Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025	47-64
	2.4.	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	64-78
IV.		**REKOMANDIMET**	**79-89**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia Dibër, si njësi e vetëqeverisjes vendore organizohet dhe funksioni sipas kuadrit legjislativ dhe operues, ku bazën e të cilave janë ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Dibër për periudhën e aktivitetit 01.01.2025-31.12.2025 , krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, (pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi), qëndron në forcimin e transparencës së veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, si dhe në rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Bashkia Dibër është një njësi e vetëqeverisjes vendore, e vendosur në verilindje të Republikës së Shqipërisë, pjesë e Qarkut Dibër. Ajo u krijua në kuadër të reformës administrative-territoriale të vitit 2015 dhe përfshin territorin e saj 15 njësi administrative: Njësia Administrative Tomin, Njësia Administrative Melan, Njësia Administrative Kastriot, Njësia Administrative Lurë, Maqellarë, Njësia Administrative Muhurr, Njësia Administrative Luzni, Njësia Administrative Selishtë, Njësia Administrative Sllovë, Njësia Administrative Kala e Dodës, Njësia Administrative Zall Dardhë, Njësia Administrative Zall Reç, Fushë Çidhen dhe Njësia Administrative Arras.

Bashkia e Dibërs kufizohet në veri me bashkinë Kukës, në veriperendim me Bashkinë Mirditë, në perendim me Bashkinë Mat, në jugperendim me bashkinë Klos, në jug me bashkinë Bulqizë dhe në lindje me Republikën e Maqedonjsë së Veriut. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Dibrës. Popullsia: Sipas rezultateve përfundimtare të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, të publikuara nga INSTAT gjatë vitit 2024, Bashkia Dibër ka: gjithsej: 50,775 banorë; Meshkuj: 25,547 (50.3%) dhe Femra: 25,228 (49.7%)

Bashkia Dibër ushtron funksionet e saj në fushat e shërbimeve publike vendore, menaxhimit financiar, planifikimit dhe zhvillimit të territorit, arsimit parashkollor, mbrojtjes sociale dhe administrimit të pasurive publike, në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Buxheti i Bashkisë Dibër për vitin 2025 është planifikuar në shumën është në vlerën 2,561,354,567 lekë dhe realizimi është në vlerën 2,343,818,470 lekë

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "*Për financat e qeverisjes vendore*", nenit 50 "*Auditi i jashtëm*", pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Dibër si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime

për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Dibër. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:
- *mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.*
- *mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.*
- *mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2025.*
- *mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.
Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. ***Vlerësimi i riskut të kontrollit;***
Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2025 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 46,876 mijë lekë dhe gabimi i lejuar *(10% - 20%)* në vlerën 4,688 mijë lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli);
Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim para që të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 16 gjetje dhe ka dhënë 16 rekomandime, nga tw cilat masa organizative 13 gjetje dhe 13 rekomandimesi dhe masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike, tw ardhura tw mungua 3 gjetje dhe 3 rekomandime.
f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.
- Nga auditimi i realizimit të buxhetit për vitin 2025 rezultoi se, ndonëse në total shpenzimet janë realizuar në masën 91.5% të planit të miratuar, janë konstatuar diferenca të konsiderueshme ndërmjet planifikimit dhe realizimit për disa kategori shpenzimesh. Konkretisht, nga fondi i planifikuar prej 2,561,354,567 lekësh janë realizuar 2,343,818,470 lekë, duke mbetur të parealizuara 217,536,097 lekë. Niveli më i ulët i realizimit konstatohet në shpenzimet kapitale (investimet), ku nga 388,510,755 lekë të planifikuara janë realizuar 265,258,531 lekë ose 68.3%, me një diferencë prej 123,252,224 lekësh. Ky mos realizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës Bashkia Dibër në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikohen angazhime buxhetore realiste. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46-Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*".
- Nga auditimi rezulton se Bashkia Dibër në datën 01.01.2025 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën

163,327,672 lekë. Gjatë vitit 2025 është likuiduar vlera prej 235,956,002 lekë për detyrimet e prapambetura. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura të raportuara nga Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit janë në vlerën 128,424,391 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" neni 55. Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", pika 153-162, Rubrika-Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura"*, pikat 82- 91.

- Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 300,000,000 lekë dhe realizimi në vlerën 205,011,111 lekë ose në masën 68% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 94,988,889 lekë.

Nga Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II, pika 2, germa "a" dhe "b", Kreu III, pika 32.

- Për vitin 2025 ndërmjet Drejtorisë së Tatim Taksave, Bashkia Dibër dhe agjentëve tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimeve, Dibër, ASHK Dibër, DSHTRR Dibër dhe Ujësjellës Kanalizime Sh.A, Dibër) nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore me përjashtim të agjentit tatimor "Ujësjellës Kanalizime Sh.A", me të cilin janë bërë çdo muaj rakordime.

Për sa i përket arkëtimeve të realizuara nga agjentët tatimore, Bashkia Dibër i referohet vetëm vlerave të arkëtuara nga agjentët tatimorë sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit, por nuk ka asnjë bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimorë dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre, veprime këto jo në përputhje me *Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore", neni 117, "Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët", pika b) "Gjobë në masën 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës në rast se nuk mban tatimin në burim apo tatimin apo nuk mbledh taksën ose tarifën". Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, "Për taksat kombëtare".*

- Nga auditimi pasqyrave financiare rezultoi se llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 104,944,016 lekë. Nga verifikimi analitik i kësaj llogarie rezultoi se në këtë shumë nuk janë përfshirë detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë që rrjedhin nga lejet e legalizimeve, në vlerën 4,360,122 lekë, si dhe debitorë familjarë në shumën 57,473,417 lekë që rezulton një total prej 61,833,539 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu III. pika 30.

- Nga auditimi u konstatua se llogaria 210 *"Toka troje terrene*", sipas Formatit nr. 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata jo materialë (kosto historike)",* paraqitet si në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 28,394,404 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie u konstatua se, nuk është pasqyruar vlera e truallit nënobjekt dhe të truallit funksional, të shkollave, kopshteve, konvikteve, godina e Bashkisë dhe ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.
- Nga auditimi i llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" dhe 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", referuar analizës së inventarit kontabël u konstatua se, vlerat investimeve për rikonstruksione, mbikëqyrje dhe kolaudimin e objekteve nuk i janë bashkuar vlerës së objekteve, si kosto shtesë e vlerës fillestare të AAGJM. Gjithashtu në llogarinë 212 "*Ndërtesa Konstruksione*" dhe 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" pasqyrohen vlera të paanlizuara me objekte, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.
- Nga auditimi i llogarisë kontabël 24 "Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara", sipas Formatit nr.7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", ku në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën prej 27,776,781 lekë, u konstatua se nga Bashkinë Dibër nuk është ngritur komision për asgjësimin dhe vlerësimin si skrap, me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave. Kjo shumë përbëhet nga pajisje kompjuterike në vlerën 4,302,583 lekë, të cilat i përkasin llogarisë 218 "Inventarë ekonomik" dhe 16 automjeteve të dëmtuara në vlerën 23,474,198 lekë, të cilat i përkasin llogarisë 215 "Mjete transporti". Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 , 85, 109, 110 dhe 111.
- Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2024, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet si biznes i vogël dhe biznes i madh në vlerën **16,383,076 lekë.** Gjatë vitit 2025 për llogari të detyrimeve që i përkasin debitorëve progresiv deri 31.12.2024 është likuiduar vlera 896,450 lekë si dhe janë krijuar debitorë të rinj për vitin 2025 në vlerën 1,401,130 lekë. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2025, për subjektet biznes i vogël dhe i madh janë në vlerën **16,887,756 lekë.**

Në lidhje me këtë situatë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dibër, për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, por në asnjë rast nuk është kërkuar kallëzim penal në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 181 "Mos pagimi i taksës dhe tatimeve". Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, ku përcaktohet që: "Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen

qendrore ose shtetasit", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore" si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10.
- Nga auditimi u konstatua se;
Abonentët familjarë debitorë në njësitë administrative dhe në qytetin e Dibër paraqiten në fund të vitit 2024 për vlerën **53,139,417 lekë**. Gjatë vitit 2025 vlera e debitorëve të rinj të krijuar është **4,333,810 lekë**. Detyrimi total progresiv në fund të vitit 2025 është në vlerën **57,473,227 lekë** nga taksat dhe tarifat për abonentët familjarë. **Ky borxh tatimor është i pakontabilizuar.** *Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore".*
Ky borxh tatimor është i pakontabilizuar, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 32.
Gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me legalizimet e ndërtimeve informale si dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, deri datë 31.12.2025, detyrimi progresiv që vjen nga kjo taksë është 4,360,122 lekë. Nga auditimi konstatohet se deri më datë 01.01.2025 vlera debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 3,287,903 lekë. Gjatë vitit 2025 janë likuiduar detyrime në vlerën 476,590 lekë por është krijuar debi për taksën e ndikimit në infrastrukturë 1,548,809 lekë. Gjendja debitore në datën 31.12.2025 rezulton në vlerën **4,360,122 lekë.**

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:
- Kryetari i Bashkisë Dibër, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Drejtorive përgjegjëse për investimet, të marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit buxhetor, duke bazuar parashikimet e shpenzimeve kapitale në analiza reale të burimeve financiare të disponueshme, nivelit të financimit dhe kapaciteteve për zbatimin e projekteve, me qëllim shmangien e planifikimeve të parealizueshme dhe rritjen e nivelit të realizimit të buxhetit.
- Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj 175 njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.
- Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër të marrë masa që në hartimin e planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.
- Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejnë akt-rakordime mujore me të gjithë agjentët tatimorë

Gjithashtu, Bashkia Dibër, në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të respektojë procedurat e parashikuara në ligj deri sanksionimin e Agjentëve Tatimorë për mosmbledhjen apo mos deklarimin e Taksave apo Tarifave Vendore.

- Drejtoria Ekonomike, Bashkia Dibër, të marrë masa për të kontabilizuar vlerën prej 61,833,539 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit dhe debitorët familjarë për taksa e tarifa vendore, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre.
- Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike, të marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve, si: llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje Plantacione", 212 "Ndërtesa e Konstruksione", 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", duke bërë dhe verifikimin në terren të tyre. Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse për sistemimin e llogarive kontabël.
- Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Dibër, të marrë masa që për "Aktivet afatgjata materiale", të vlerësuara të dëmtuara në vlerën 27,776,781 lekë, të bëjë grupimin duke caktuar një person përgjegjës, si dhe të ngrejë komision për asgjësimin dhe vlerësimin e tyre për skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave.
- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2025 në vlerën progresive 16,887,756 lekë, ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar.
- Në lidhje me këtë situate, nga ana e Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dibër, përveç njoftimit për pagesën e detyrimeve 57,473,227 lekë nga taksat dhe tarifat për abonentët familjarë dhe 4,360,122 lekë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve informale, për një total prej 61,833,349 lekë, si dhe nxjerrjes së urdhër bllokimit të llogarive, të ndiqet praktika deri në kallëzim penal për subjektet që nuk paguajnë detyrimet tatimore.

I.1. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2025:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Dibër për periudhën ushtrimore 2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Dibër, nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin e Kualifikuar", dhe në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një e një **opinioni të kualifikuar"[1]**, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

[1] Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 "Për miratimin e manualit të auditimit financiar " të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (fa që 54 dhe 60-61), "Një "Opinion i Kualifikuar", jepet në rastet kur: audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të

Baza për opinionin e kualifikuar:
Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Dibër, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).
Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 është 43,480 mijë lekë.
Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë parregullsitë si më poshtë:
- Llogaria 210 *"Toka troje terrene*", 212 "Ndërtesa Konstruksione" dhe 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*", janë pasqyruar për vlerën kontabël pa u krahasuar me inventarin fizik.
-Nga auditimi ka rezultuar se në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm*", nuk janë përfshirë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve për vlerën ***4,360,122 lekë*** dhe debitorët familjarë për taksa e tarifa vendore në vlerën ***57,473,227 lekë,*** **lekë**.
- Nga auditimi ka rezultuar se në llogaritë 212 "Ndërtesa Konstruksione" dhe 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", vlerat e rikonstruksioneve, mbikëqyrje dhe kolaudimi nuk i janë shtuar vlerës së aktivit për investimet e kryera. Gjithashtu janë të pa analizuara me objekte vlera prej 135,940,644 lekë, për llogarinë 212 "*Ndërtesa Konstruksione*" dhe vlera prej 41,330,544 lekë për llogarinë 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*".

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së i ndryshuar, nga data 14.04.2026 deri në datë 29.05.2026, në subjektin Bashkia Dibër për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025 u krye auditimi *"Mbi auditimin Financiar"*, nga grupi i auditimit me përbërje:
1. A. V., Përgjegjës grupi,
2. S. D., auditues;
3. K. P., auditues;

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionët financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*"*

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.
Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

2. Identifikimi i çështjes.
Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Dibër, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Dibër.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.
Kryetari i Bashkisë Dibër ***(****Administratori i Përgjithshëm)*, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Dibër, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetë qeverisjen vendore*", konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.
NA i njësisë së vetë qeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.
Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.
Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet

buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.[2]
Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Dibër me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.
Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.
Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia, vlerësimi, periudha, klasifikimi, kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.
Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Dibër është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.
Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:
- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm publik"; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për

[2] Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 15

vetë qeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetë qeverisjes Vendore"; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues"; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore"; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" i ndryshuar; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" etj. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "Për përgatitjen e buxhetit vendor"; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetë qeverisjes vendore".

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial"; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 "Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial", Udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetë qeverisjes vendore" .

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar"; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për sistemin e taksave lokale", i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave " i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë", i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, "Për pagat e vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "Udhëzues të Auditimit Financiar"; ISSAI 2300 "Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare"; INTOSAI GOV 9100 "Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik" si dhe INTOSAI GOV 9110 "Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm";.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar -së; Manuali

i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropianë të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- Intervistimi është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u hartuan dhe u mbajtën 5 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikimi. Gjatë hartimit të Raportit, sipas përcaktimeve ligjore janë paraqitur observacione nga subjekti Bashkia Dibër, përcaktuar më shkresën nr. 2814 prot,, datë 24.06.2026, protokolluar në KLSH me shkresën nr.551/2.prot, datë 29.06.2026.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Dibër u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi dhe menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, menaxhimin, inventarizimin dhe hipotekimin e pronave/aseteve.
Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Zona Gjeografike: Zona gjeografike e Bashkisë Dibër

Bashkia Dibër ndodhet në verilindje të Shqipërisë, në Qarkun Dibër, me qendër administrative qytetin e Peshkopi. Ajo u krijua pas reformës administrativo-territoriale të vitit 2015 dhe ka një sipërfaqe prej rreth 937.9 km².
Kufijtë administrativë:
- Në veri kufizohet me Bashkinë Kukës.
- Në veriperëndim me Bashkinë Mirditë.
- Në perëndim me Bashkinë Mat.
- Në jugperëndim me Bashkinë Klos.
- Në jug me Bashkinë Bulqizë.
- Në lindje kufizohet me Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Popullsia: Sipas rezultateve përfundimtare të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, të publikuara nga INSTAT gjatë vitit 2024, Bashkia Dibër ka:
- Popullsi gjithsej: 50,775 banorë
- Meshkuj: 25,547 (50.3%)
- Femra: 25,228 (49.7%)

Misioni i Bashkisë Dibër është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.
Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të

balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.
Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:
a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.
Bashkia Dibër, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" dhe ligji nr.68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.
Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Dibër për periudhën e aktivitetit 2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik për vitin 2025.

2.1.2. Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.
2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Dibër, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.
Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

1. Komponenti "Mjedisi i kontrollit"

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Dibër në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se Bashkia Dibër ka miratuar Rregulloren e Brendshme për vitin 2025 me Vendimin nr.120, datë 28.05.2025, "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Dibër dhe të Njësive Administrative". Në këtë dokument janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit në përputhje me strukturën organizative.

Në Bashkinë Dibër është miratuar kodi i etikës me Vendimin nr.155, datë 27.03.2024, por Bashkia ka përshtatur përcaktime të Kodit të Etikës me anë të disa dispozitave në Rregulloren e Brendshme me nr.120, datë 28.05.2025.

Një problematikë e evidentuar lidhur me këtë parim është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore.

Rregullorja e Brendshme është e afishuar në faqen zyrtare të Bashkisë.

Bashkia ka procedura të shkruara për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave.

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se për vitin 2025, *Bashkia nuk ka përcaktuar procedura për mbrojtjen ndaj sinjalizuesve dhe nuk ka mekanizma të cilat i dedikohen ankesave për korrupsion.* Gjithashtu konstatohet se nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të ndershëm.

Gjatë vitit 2025 janë marrë 18 masa disiplinore:

Bashkia vlerëson performacën e personelit nëpërmjet vlerësimeve të punës të cilët përmbajnë edhe elementë të vlerësimit dhe monitorimit për zbatimin e rregullave të etikës.

Parimi 2 -Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohen se nuk ka raportime periodike mbi monitorimin e planit të veprimit për KB.

Nga Drejtoritë dhe Sektorët nuk janë hartuar planet mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve.

Në Rregulloren e Brendshme nr.120, datë 28.05.2025 është përcaktuar përgjegjësia menaxheriale e drejtuesve të të gjitha strukturave të bashkisë të cilët janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari, sipas shkallës hierarkike, eprorit direkt deri tek Kryetari ose tek nëpunësit të cilëve kryetari u ka deleguar përgjegjësinë, për: Hartimin dhe monitorimin e planeve vjetore dhe periodike në përputhje me objektivat strategjike, afatmesme si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit, menaxhimin/administrimin e risqeve/problemeve që vënë në rrezik

arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë (nëpërmjet identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit periodik të zbatimit të masave për zvogëlimin e risqeve), informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësive të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejtojnë, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve

Për periudhën e aktivitetit të vitit 2025, nëpërmjet shkresës nr. 908 prot., datë 27.02.2026 është dërguar pranë MFE-së "Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm", si dhe "Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm" dhe "Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon", për vitin e mëparshëm.
Në raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të Bashkisë Dibër për vitin 2025, citohet se: Në lidhje me masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit theksojmë se janë miratuar prioritetet e investimeve bazuar në analizën e faktorëve që kanë impakt më të madh në komunitet.
Për sa trajtuar më sipër, rezulton se në formatin e këtij raporti nuk përfshihen të gjithë kapitujt/elementët e parashikuar në Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike", Shtojca nr. 2. E konkretisht:
-Vlerësimin e sisemit të MFK-së në të cilën përfshihet:
Gjendja aktuale e sistemit të MFK-së; objektivat e përmbushura gjatë periudhës së raportimit si dhe vlerësimin i cili duhet të paraqitet për çdo komponent të menaxhimit financiar dhe kontrollit me fokus kryesisht tek: mjedisi i kontrollit; vendosja e objektivave; identifikimi i ngjarjeve, vlerësimi i riskut; përgjigjja ndaj riskut; aktivitetet e kontrollit; informacioni dhe komunikimi; monitorimi.
-Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në të cilën përfshihet:
Gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për vitin e raportimit, si dhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit për përmirësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm.
-Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen në të cilën përfshihet:
Masat e marra nga titullari dhe vetë nëpunësi autorizues gjatë vitit raportues për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, minimizimin e risqeve prioritare që pengojnë përmbushjen e objektivave dhe plan veprimet për të ardhmen bazuar në rekomandimet auditit të brendshëm apo të jashtëm, si dhe menaxherët e njësisë.
-Rekomandime të përgjithshme për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm në të cilën përfshihet:
Rekomandimet për përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e kontrollit të brendshëm, për ndjekje të mëtejshme nga njësitë qendrore të harmonizimit të Ministrisë së Financave.
Pjesë e shkresës përcjellëse nr. 368 prot., datë 15.03.2023, është edhe plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.

Bashkia nuk ka hartuar Planin e Menaxhimit të risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

Institucioni vepron mbi bazën e rregullore të brendshme të miratuar me Vendimin nr.120, datë 28.05.2025, "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Dibër dhe të Njësive Administrative" e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive.

Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PPV-ve, si dhe në Relacionin e Buxhetit. PPV është i publikuar në faqen ëeb të bashkisë https://diber.gov.al/.

Me Vendimin Nr. 2, datë 02.12.2024, "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Dibër, Institucioneve të varësisë dhe të Njësive Administrative për vitin 2025" është miratuar struktura e përbërë nga **898** punonjës, ndër të cilat **114** nëpunës civilë.

- **Struktura organizative e bashkisë**

Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:

Funksionet politike: Kryetari; Zëvendëskryetarët; Administratoret; Kabineti. Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë dhe funksionarëve të kabinetit të bashkisë bëhet me Urdhër të Kryetarit.

Nëpunësit civilë: Shërbimi Civil në bashki organizohet dhe funksionon sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:

- Nëpunës të nivelit te lartë drejtues: - Sekretari i Përgjithshëm.
- Nëpunës të nivelit te mesëm drejtues: - Drejtorë Drejtorie
- Nëpunës të nivelit të ulët drejtues: - Përgjegjës Sektori
- Nëpunës të nivelit ekzekutiv: - Specialistët.

Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë.

Struktura e Bashkisë Dibër për vitin 2025

		Nëpunës Civilë	**114**
Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	**898**	Nëpunës me kontratë	**784**
Numri i të punësuarve me kontratë provizore		-	-
Vende vakante		-	

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Dibër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Përgjatë vitit 2025, janë rekrutuar **73** punonjës të rinj. Në dosjet e personelit, nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës.
Bashkia Dibër ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.
Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku konstatohet se bashkia përdor procedurat për delegimin e detyrave.

Parimi 4 -Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave
Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.
-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.
Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë Bashkisë Dibër
Përgjatë vitit 2025, janë rekrutuar **73** punonjës (nëpunës civil dhe punonjës me kontratë), pranë Bashkisë Dibër. Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, pavarësisht se nuk ka një plan vjetor rekrutimi.

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka verifikuar respektimin e kuadrit ligjor nga ana e bashkisë për rekrutimin (punësimin) e punonjësve gjatë kësaj periudhe kohore, konkretisht:
1-Për punësimin e **z. A. D.,** i punësuar me vendimin nr. 151 datë 27.06.2025, "Për Emërim të Përkohshëm në Detyrë" i Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin "Elektricist pranë Sektorit të Transportit dhe Ndriçimit Publik", Drejtoria e Shërbimeve Publike, nga verifikimi i dosjes së personelit nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.
2-Për punësimin e **z. L. K.**, i punësuar me vendimin nr. 220 datë 19.08.2025, "Për Emërim në Detyrë" i Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin "Administrator", pranë Njësisë Administrative Tomin, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton e dokumentuar nga ana e Bashkisë Dibër, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

Si konkluzion, punësimi pranë Bashkisë Dibër i nëpunësve për të cilët nuk është zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi e hapur, përveçse bie ndesh me interesin publik, parimin e konkurrencës së lirë dhe barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar duke ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e punës në Bashkinë Dibër.
Për sa më sipër, Bashkia Dibër ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën e R. Sh., ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Burimeve Njerëzore**.**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 107, pika 2*, ku përcaktohet se: "Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.";*

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit konstatohet se për 2 punonjës me profesion elektricist nuk janë të pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, "Për garantimin e sigurisë së punës të

pajisjeve dhe të instalimeve elektrike" i ndryshuar. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës
1	A. B.	Elektricist
2	Sh. M.	Elektricist

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.
Nga drejtoria juridike dhe e burimeve njerëzore nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.
Nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.
Për vitin 2025 janë kryer nga ASPA, **18** trajnime ku ka marrë pjesë **18** nëpunës të institucionit.
Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të ligjit 114/2015 "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit".

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale
Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.
Nga auditimi i kryer rezulton se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe nuk ka autorizime për delegimin e detyrave.
Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.
Për vitin 2025, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 19, datë 24.01.2025, *"Për krijimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik" (GMS)* Në këtë urdhër, komisioni ka në përbërje **17** anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë.
Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se takimet e GMS nuk dokumentohen me procesverbale. Vlen të theksojmë se GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20;
-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.1 "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK" a, b, c, d, pika 2.3.1;
-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Kreu II. "Dosja e Personelit";
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.1, Kapitulli IV "Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit", Kapitulli V, Anekset.

2. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Nga auditimi i kryer konstatohet se, bashkia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në të cilin evidentohen objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Dokumenti përfundimtar i PBA-së 2025-2027 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 05 datë 15.01.2025 "Për miratimin e Programit Buxhetor për vitin 2025". *Ky dokument nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë.*

Bashkia nuk ka hartuar plan-veprime operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), por objektivat e parashikuara ne buxhetin vjetor kane si baze PBA-në. Rezulton se objektivat e miratuara i komunikohen stafit të bashkisë nëpërmjet emailit apo shkresave zyrtare.

Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se njësia publike ka krijuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.

Nuk janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priotizimin e risqeve të përputhshmërisë.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

Nga auditimi i kryer konstatohet se bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. *Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.*

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se nuk ka sistem të Kontrollit të Brendshëm.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2;
-Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 3 "Përgjegjësitë dhe detyrat e KR", pika 3.2.1 "Titullari i njësisë publike" pika 4 "Hapat për ngritjen e sistemit të MR"
-"Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.

3. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"
Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.
Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.
Në vijim t ë auditimit të kryer, konstatohet mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.
Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
Listë prezencat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës dhe listë pagesa përpilohet nga specialisti i pagave, të dhënat hidhen çdo muaj në librin e pagave.
Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.)
Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP.... dhe krijimi i tyre në sistemin e PP" është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.

Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit dhe në Bankën e Shqipërisë.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

Bashkia nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS etj.) dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it.

Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces. *Bashkia nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.*

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

Bashkia ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. *Ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.*

- **Gjurma e auditimit**

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, **bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës.** Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 5.2.7 "Monitorimi dhe Raportimi";

-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

4. Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të auditimit, konstatohet se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por *ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.*

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Nuk ka sistem për kontabilizimin e të dhënave në bashki.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se janë hartuar procedura të shkruara për të siguruar që menaxherët dhe personeli i bashkisë të informohen mbi që të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve dhe nismat e tjera të bashkisë.

B*ashkia përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike.* Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe **evidentohet që punonjësit përdorin adresat zyrtare të e-mailit.** Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësisë të informacionit lidhur me: Dokumentin e Buxhetit vjetor të propozuar; Buxhetin e miratuar të bashkisë; Raporte periodike të zbatimit të buxhetit; Pasqyrat vjetore financiare të dhe të buxhetit; Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit, kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet; Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës.

Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 23, "Informacioni dhe Komunikimi" pika 2;

-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

5. Komponenti: "Monitorimi"

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm.

Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

NJAB ka hartuar planin strategjik, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 3708 prot., datë 15.10.2024, të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2025.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, "Monitorimi" pika 1;

-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

- **Sa më sipër arrihet në konkluzion se:**

Përsa i përket sistemit të MFK: Bashkia ka ngritur një sistem jo efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar planet vjetore të punës.

- Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës.

-Dosjet personale të punonjësve kanë disa mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, vlerësimet periodike të punonjësve dhe formularët e përshkrimeve të punës. Punësimi i **1** punonjësi në kushtet e mosplotësimit të kritereve të kërkuara dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

2. 1. 2. Organizimi, përbërja dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm

Në zbatim të Ligjit Nr.114/2015, datë 20.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:

"*Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në germat a-c të kësaj pike"*, është ngritur dhe funksionon Sektori i Auditit të Brendshëm në varësi funksionale nga Titullari i Bashkisë Dibër, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

NJAB, përgjatë periudhës objekt auditimi, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit nr.02 datë 02.12.2024"Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, institucioneve të varësisë dhe Njësitë Administrative për vitin 2025", duke pasur në strukturën e saj 1 (një) Përgjegjës i Auditit të Brendshëm z. E. M. dhe 3 (tre) specialistë auditi, z. H. D., i certifikuar si audites i brendshëm, ***znj. E. D. dhe zj. M. B. në proces certifikimi si audituese të brendshme***.

Tabela nr. 1 Struktura e njësisë AB për vitin 2025

Nr.	Periudha	Funksioni	Arsimi bazë	Niveli i diplomës	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime te vijueshme
	Për vitin 2025							
1	E. M.	Përgjegjës	Ekonomist	Master Shkencor	8	4	2023	Jo
2	H. D.	Specialist	Bankë-Financë	M.Profesional	19	6	2023	Jo
3	E. D.	Specialist	Bankë-Financë	Bachelor/MSH viti 2024	10	7	x	Jo
4	M. B.	Specialist	Menaxhim-marketing	M.Profesional	5	5	x	Jo

Burimi: NJAB Dibër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Trajnimet e NjAB dhe certifikimet

Audituesit e brendshëm duhet të zgjerojnë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e drejtuesit të auditimit të brendshëm ose struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo audites duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikat e reja të auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se ***nuk i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve të NJAB sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.***

Komiteti i Auditit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, është krijuar nga Bashkia Dibër.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, neni 12, pika b, i cili përcakton se titullari i njësisë publike është përgjegjës për: "***Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike përkatëse sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave,*** sipas shkronjës "b" të nenit 23 të këtij ligji".

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të ligjit 114/2015 "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit".

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik"* ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" në Bashkinë Dibër e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr.197 prot, datë 15.01.2025, dhe rezulton se është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016".

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.

Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:

"Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën **10 Tetor të çdo viti**. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data **20 Tetor e çdo viti**, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm….."

Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publik edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm.

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar Plani Strategjik 2025-2027 i cili është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr.3708 prot., datë 10.10.2024.

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.3708 prot., datë 15.10.2024, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2025

Nga auditimi rezultoi se:

Në planin vjetor të auditimit për vitin 2025, miratuar me shkresën nr.3708 prot., datë 15.10.2024, janë programuar për auditim, drejtori brenda strukturës së Bashkisë dhe institucione në varësi të saj.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, Njësia e Auditimit të Brendshëm janë planifikuar për t'u kryer 8 auditime kundrejt 14 auditimeve të programuara, pra plani vjetor është realizuar 57%, nga të cilat 8 auditime paraqiten në statusin "*Angazhime të përfunduara*" pasqyruar si më poshtë:

Tabela nr. 2

Nr.	Planifikuar	Nr.	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr.	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputhsh	Perform	Financ	IT	Kombin		
1	Qendra Kulturore"Pallati i Kulturës",	1	Qendra Kulturore"Pallati i Kulturës",	1	1					1	
2	Qendra Balneare Peshkopi	1	Qendra Balneare Peshkopi	1	1					1	
3	Njësia Administrative Tomin.	1	Njësia Administrative Tomin.	1	1					1	
4	.Njësia Administrative Maqellarë.	1	.Njësia Administrative Maqellarë.	1	1					1	
5	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	1	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	1					1	1	
6	Drejtoria e Rinisë Sporteve dhe Higjenës.	1	Drejtoria e Rinisë Sporteve dhe Higjenës.	1					1	1	
7	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Medias	1	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Medias	1	1					1	
8	Zbatimi i Rekomandimeve të lëna	1	Zbatimi i Rekomandimeve të lëna	1						1	
		8	**Totali**	**8**	**5**	**0**	**0**	**0**	**2**	**8**	

Burimi: NJAB Dibër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivitetin e vitit 2025 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 2687 prot., datë 18.06.2026.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2025, rezulton se janë dhënë 44 rekomandime gjithsej, të cilat janë të karakterit organizativ. Rekomandimet janë pranuar të gjitha, prej të cilave 12 rekomandime janë zbatuar,23 janë në poçes zbatimi dhe 9 nuk janë zbatuar.

Tabela nr. 3

Nr.	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Pranuar	Zbatuar	Ne proces	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2025	44	44	12	23				9
TOTALI		**44**	**44**	**12**	**23**				**9**

Burimi: NJAB Dibër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konstatim: Për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Dibër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Sektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit pika 3.1.3 ku citohet: *"Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit"*

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB

Grupi auditimit duke patur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2025, zgjodhi të auditojë dosjen e cila është vlerësuar nga DAB me nivel të mesëm dhe të lartë risku siç është:

-dosja e auditimit të kryer në Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;

1.Dosja e auditimit e performancës dhe përputhshmërisë për subjektin, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.

Objektivi kryesor i subjektit të audituar konsiston në: Zbatimin e rregullave, procedurave dhe kërkesave ligjore nga punonjësit e Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi**.**

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:

- Të ndihmojë subjektin që do të auditohet në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit.

Gjetja e konstatuar:

I. Nga auditimi u konstatua se nga kjo drejtori nuk është bërë identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut, në lidhje me programimin dhe realizimin e detyrave si dhe mungon Regjistri i Riskut.

Rekomandimi i lënë:

"Të bëhet identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut, në lidhje me programimin dhe realizimin e detyrave, si dhe të hartohet Regjistri i Riskut konform Ligjit nr. 10296 , datë 08.07.2010 'Për menaxhimin financiar dhe kontrollin' i ndryshuar dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

II. Nga auditimi u konstatua se aktiviteti i Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi është mbështetur në rregulloren e brendshme në të cilën janë përcaktuar detyrat e personelit të këtij sektori, por kjo rregullore nuk është përditësuar me ndryshimet e fundit.

Rekomandimi i lënë:

"Nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi të përpunohet dhe të përditësohet rregullorja e brendshme për stafin e saj. Si dhe të përcaktohen detyra të qarta, konkrete, të plota dhe praktike, për të mundësuar kontrollin dhe menaxhimin e realizimit të objektivave".

IV. Sipas informacionit verbal dokumentacioni për shpenzimet e kryera në Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi ndodhet në drejtorinë e burimeve ekonomike, aty ku finalizohet veprimi.

Rekomandimi i lënë:

"Një kopje e dokumentacionit të mbahet nga sektori i gjelbërimit, për të dokumentuar më mirë punën e tij".

Konstatim:

- Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;
- NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;
- Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;

Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm , si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë , vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Dibër ka hartuar*"Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm"* i cili rezulton të jetë i miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 3708 prot., datë 15.10.2024.

Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Dibër në përputhje me ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit"e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 3726 prot., datë 02.12.2021.

Dosja e përhershme

Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se audituesit e brendshëm nuk kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit në mos përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm ku përcaktohet se: ***Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.*** Dosja e përhershme duhet të përditësohet pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e saj. Dosja e përhershme mbahet në format elektronik ose të printuar, kjo në funksion të mundësive të NjAB.

Konstatim: NjAB në Bashkinë Dibër nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 *"Dosja e Përhershme".*

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenet 12, 13 të Ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, i ndryshuar;

-Për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Dibër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Sektori i Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit;

-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;

-NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;

-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;

- NjAB në Bashkinë Dibër nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 *"Dosja e Përhershme".*

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit për periudhën 2025.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.
2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;
2.2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.

Në zbatim të pikës nr. 2, të Programit të Auditimit nr. 551/1 prot, datë 22.05.2026 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA 2025-2027, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministritë e Linjës;
2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;
4. Akt Rakordimi i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve;
6. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
7. Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.
8. Dokumentacion të bankës etj.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin e PBA dhe programimit të buxhetit vjetor.

- *Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2025-2027 .*

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027 u konstatua se:
- Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për PBA 2025-2027 me Urdhrin nr. 19 datë 24.10.2025.
- Është përgatitur dhe miratuar kalendari i PBA 2025-2027 dhe buxhetin vjetor 2025 me VKB nr.850 datë 01.03.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 208/1 prot., datë 04.03.2024.
- Janë miratuar për PBA 2025-2027 me VKB nr.1323 datë 09.04.2024 "Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2025-2027 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.313/1 prot., datë 11.04.2024. Vlerësimi i të ardhurave është paraqitur në Këshillin Bashkiak, në kundërshtim me afatet e përcaktuar në pikën 58 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
- Janë miratuar në Këshillin Bashkiak tavanet përgatitore për PBA 2025-2027 me VKB nr. 26, datë 05.04.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.313/1 prot., datë

11.04.2024 në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34/6.*
Nuk është hartuar Udhëzimi i Kryetarit të Bashkisë në kundërshtim me neni 34 ligjit nr. 68/2017"*Për financat e vetëqeverisjes vendore*"
- Faza e dytë e PBA 2025-2027 është miratuar ne Sistemin e Menaxhimit te Buxhetit Vendor me datë 15.09.2024.
- Faza e tretë PBA 2025-2027 është miratuar ne Sistemin e Menaxhimit te Buxhetit Vendor me datë 06.02.2025.
Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetit vjetor janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje", ku për të cilat janë mbajtur relacionet dhe protokollet përkatëse sipas datave: 29.10.2024 deri me 05.12.2024,sipas shkresës me objekt "Ftese për dëgjesë publike".
- Buxheti vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027 është miratuar me VKB nr. 05, datë 15.01.2025 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 31/1 prot., datë 20.01.2025. Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjeçar sipas programeve si për shpenzimet korente, ashtu edhe për investimet dhe të ardhurat.

Programimi i shpenzimeve për vitin 2025-2027 Bashkia Dibër dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA. Buxheti vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027është miratuar me VKB nr. 05, datë 15.01.2025 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 31/1 prot., datë 20.01.2025.

Tabela nr.4

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe administrimi (01110)	383,864	381,168	386,026
2	Shërbimet e policisë vendore (03140)	10,604	11,900	11,000
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (03280)	44,785	42,741	42,801
4	Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit (04240)	5,699	27,750	28,500
5	Shërbimet bujqësore, inspektimi,ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve (04220)	17,972	0	0
6	Menaxhimi I pyjeve dhe kullotave (04260)	19,359	9,806	10,806
7	Rrjeti rrugor rural (04520)	294,806	231,390	249,160
8	Fondi rezervë (04910)	9,000	10,000	10,000
9	Fondikontigjences (04940)	13,350	3,000	3,000
10	Menaxhimi I mbetjeve (5100)	39,657	38,548	38,038
11	Sherbimet publike vendore (06260)	140,431	133,306	136,485
12	Furnizime me uje dhe kanalizime (06370)	13,933	11,576	13,767
13	Sherbimet e kujdesitparesor (07220)	43,039	37,945	38,418
14	Sport dheargetim (08130)	50,392	40,852	37,611
15	Trashegimia kulturore, monumentet, muzete dhe bibliotekat (08220)	25,388	21,888	22,488
16	Arsimibazeperfshiresitemin e arsimitparashkollore (09120)	268,490	283,027	285,615
17	Arsimi I mesem I pergjithshem (09230)	40,048	41,294	45,794
18	Kujdesi social per familjetdhefemijet (010430)	41,411	39,317	38,995
	Total	**1,462,229**	**1,365,508**	**1,398,503**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike sektori i financës.*

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2025.

Për vitin 2025, buxheti është miratuar me VKB nr. 05, datë 15.01.2025,i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 31/1 datë 20.01.2025. Sipas VKB nr. 05 *"Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025"* rezulton se të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2025 kanë vlerën 652,117 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar sektoriale ka vlerën 348,339 mijë lekë, të ardhura nga taksa dhe tarifa ka vlerën 300,000 mijë lekë**.**
i detajuar planifikimi i buxhetit fillestar për vitin 2024 paraqitet në vijim:

Tabela 5:Të dhënat mbi buxhetin fillestar *000/lekë*

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i Vitit 2025	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	652,117	
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	348,339	
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	300,000	
4	Të ardhura të tjera	40,000	
1	Shpenzime për paga (600)		699,124
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		116,833
3	Shpenzime operative		218,797
4	Subvencione (603)		
5	Transferta (604+606)		15,780
6	Fondi rezervë+Fondi I kontigjencës (609)		22,000
7	Shpenzimetkapitale (230+231)		267,922
8	Principali+Interesi I kredisë (166+651)		
	Total	**1,340,456**	**1,340,456**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike.*

Rezulton se buxheti i konsoliduar është miratuar i balancuar dhe pa deficite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 1,340,456 mijë lekë.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësimi). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla. Gjatë vitit 2025 janë miratuar disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë.

Tabela nr. 6 : Paraqiten të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit dhe ndryshimet për vitin 2025 sipas VKB përkatës:

Buxheti Fillestar			Ndryshimet Gjate Vitit			Pakësuar/Shtuar Artikulli Me Emër			
Vkb Nr.	**Date**	**Vlera**	**Vkb Nr.**	**Date**	**Vlera**	**Shtese Art**	**Shuma**	**Pak Art**	**Shuma**
5	15.01.2025	1,340,456,292							
			22	02.07.2025	4,000,000	231	4,000,000	602	1,966,700
								231	2,033,300
			24	02.07.2025	900,000	606	900,000	609	900,000
			29	22.07.2025	4,031,997	231	4,031,997	602	867,481
								231	3,164,516
			43	03.09.2025	7,500,000	231	7,500,000	231	7,500,000
			53	01.10.2025	2,169,438	602	2,169,438	606	2,169,438
			477	10.10.2025	32,871,554	600	27,382,004	231	32,871,554
						601	5,489,550		
			80	03.11.2025	15,766,000	600	15,766,000	Akt Nor.	
			11	19.12.2025	52,005,043	602	10,727,973	Akt Nor.	
						609	1,550,058	Akt Nor.	
						231	33,616,000	Akt Nor.	
		1,340,456,292					**113,133,020**		**51,472,989**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, sektori i financës*

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga Sektori i Buxhetit dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë .

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Dibër, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Tabela nr. 7. Për vitin 2025 realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet **në tabelën e** mëposhtme:

Institucionet	600 (paga)		601 (sigurime)		602 (ShP. Operative)		603-609 (trans individë)		230-231 (investimet)		Totali	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bashkia	684,714,444	684,435,238	112,710,952	112,696,249	187,101,772	142,195,195	36,260,624	7,601,026	325,177,480	210,130,977	1,345,965,272	1,157,058,685
Njësite shpenzuese	56,885,345	55,713,781	9,498,319	9,317,068	45,331,156	43,872,141	900,000	765,000			112,614,820	109,667,990
Fonde të kushtëzuara	15,473,125	15,472,936	2,516,628	2,515,785	17,710,591	17,469,360	1,003,740,856	986,506,160	63,333,275	55,127,554	1,102,774,475	1,077,091,795
TOTALI	**757,072,914**	**755,621,955**	**124,725,899**	**124,529,102**	**250,143,519**	**203,536,696**	**1,040,901,480**	**994,872,186**	**388,510,755**	**265,258,531**	**2,561,354,567**	**2,343,818,470**
% e realizimit		**99.8**		**99.8**		**81.4**		**95.6**		**68.3**		**91.5**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, sektori i financës*

Nga auditimi i realizimit të buxhetit për vitin 2025 rezultoi se, ndonëse në total shpenzimet janë realizuar në masën 91.5% të planit të miratuar, janë konstatuar diferenca të konsiderueshme ndërmjet planifikimit dhe realizimit për disa kategori shpenzimesh. Konkretisht, nga fondi i planifikuar prej 2,561,354,567 lekësh janë realizuar 2,343,818,470

lekë, duke mbetur të parealizuara 217,536,097 lekë. Niveli më i ulët i realizimit konstatohet në shpenzimet kapitale (investimet), ku nga 388,510,755 lekë të planifikuara janë realizuar 265,258,531 lekë ose 68.3%, me një diferencë prej 123,252,224 lekësh. Ky mos realizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës Bashkia Dibër në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikohen angazhime buxhetore realiste. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46-Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", ku thuhet: "*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshim*

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre
Për vitin 2025 janë planifikuar fonde për investime në shumën 388,510,755 lekë (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura + transfertë e kushtëzuar) dhe janë realizuar në vlerën 265,258,531 lekë, ose në masën 78.8%.

Fondet për investime nga të ardhurat e Bashkisë
Për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 111,208 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 48,901 mijë lekë ose realizuar në masën 43.9%. Janë planifikuar fonde për financimin e 35 projekteve të investimit, nga të cilat 4 projekte janë financuar pjesërisht, 22 projekte nuk janë realizuar dhe 9 projekte janë financuar plotësisht sipas planit të vitit.

Fondet për investime të financuara nga Ministritë e Linjës
Për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 63,333 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 55,128 mijë lekë ose në masën 87%% për 5 projekte.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe kontigjencës si dhe fondeve të emergjencave civile
a. Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.
Për vitin 2025 fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës është në total në shumën 22,350 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr. 05 prot., datë 15.01.2025 "Për miratimin e Buxheti vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027 i Bashkisë Dibër, dhe u konfirmua nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 31/1 datë 20.01.2025.

Për vitin 2025 me shkresën nr. 11prot., datë 19.12.2025, të ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, (AKMC), "Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile" Bashkisë i është akorduar *fondi në vlerën plan* 13,905,950 lekë dhe fakt 13,905,909**,** sipas VKB-ve të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 8 *Në lekë*

Nr.	VKB	Kthim Vendim Rishqyrtim	Emri	Mbiemër	Vlera Demit Financiar	Vlera e likuiduar
1	Nr.54 Dt.01.10.2025	Nr. 883/1, Dt 13.10.2025	E.	D.	1,910,508	1,328,146
2	Nr.5 Dt 01.10.2025	Nr.884/1 , Dt 13.10.2025	L.	C.	1,917,508	1,333,012
3	Nr. 56 Dt.01.10.2025	Nr. 885/1, Dt 13.10.2025	Y.	K.	2,265,010	1,574,589
4	Nr. 57 Dt 01.10.2025	Nr. 886/1, Dt 13.10.2025	Xh.	T.	2,616,994	1,819,281
5	Nr. 58 Dt 01.10.2025	Nr. 887/1, Dt 13.10.2025	Z.	F.	3,999,092	2,780,088
6	Nr. 59 Dt 01.10.2025	Nr. 888/1, Dt 13.10.2025	B.	K.	552,784	384,283
7	Nr. 60 Dt 01.10.2025	Nr. 889/1, Dt 13.10.2025	A.	T.	1,950,647	1,356,050
8	Nr.07 Dt. 29.01.2025	Nr. 84/1/1 Dt 05.02.2025	K.	S.	3,330,459	3,330,459
	Totali				**18,543,000**	**13,905,909**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, sektori i financës*

Gjatë vitit 2025 nga fondet e deleguara janë planifikuar 6,203,546 lekë dhe janë përdorur 3,330,459 lekë për ndihmë financiare familjeve të dëmtuara nga zjarri. Këto fonde jepen të detajuara si më poshtë:

- Me VKB nr.07 prot., datë 29.01.2025 për dhënien e ndihmës financiare z. K. S, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij në vlerën 3,330,459 lekë.

Mbi monitorimin e buxhetit.
Për vitin 2025 Bashkia Dibër me shkresën nr. 1973 prot., datë 30.05.2024, ka përcjellë në MFE Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për 4 mujorin e parë. Për 8 mujorin për vitin 2025 është dërguar në MF me shkresën nr. 3861prot., datë 30.09.2025. Me shkresën nr. 886 prot., datë27.02.2026 ka përcjellë në MFE raporti mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit për 12 mujorin e vitit 2025.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;

Nga auditimi rezulton se Bashkia Dibër në datën 01.01.2025 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 163,327,672 lekë. Gjatë vitit 2025 është likuiduar vlera prej 235,956,002 lekë për detyrimet e prapambetura. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura të raportuara nga Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit janë në vlerën 128,424,391 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" neni 55. Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 153-162, Rubrika-Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura"*, pikat 82- 91.

Tabela nr. 9 *Në lekë*

Detyrimet e NJQV	Detyrimi ne fillim te vitit I mbartur 31.12.2024	Detyrimi i krijuar ne periudhën 01.01.2025-31.12.2025	Total Detyrime	Shlyerje e detyrimeve 2025	Mbetja e detyrimeve ne fund te periudhës 31.12.2025
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministrite e linjës e FZHSH	22,822,038		22,822,038		22,822,038
b. Investime nga Bashkia	109,182,351	114,847,303	224,029,654	160,566,290	63,463,364
Investime:	132,004,389	114,847,303	246,851,692	160,566,290	86,285,402
Mallra dhe shërbime	22,957,559	65,963,338	88,920,897	48,724,003	40,196,894
Vendime gjyqësore	8,365,724	20,242,080	28,607,804	26,665,709	1,942,095
Totali	**163,327,672**	**201,052,721**	**364,380,393**	**235,956,002**	**128,424,391**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, sektori i financës*

a. Mbi vonesat në likuidime:

Grupi i auditimit kreu me zgjedhje testime për të identifikuar pagesat e kryera për periudhën objekt auditimi me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit. Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, neni 52 dhe* në ligjin Nr.48/2014 *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.* Nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor**.** Konkretisht, janë likuiduar **263 fatura** mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji për "*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor*" si dhe ligjin nr. 48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtare*" *neni 7*, Tejkalim të afateve që parashikon ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", i ndryshuar, neni 52 ku citohet: "*specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e*

pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së", dhe si pasojë duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (prapambetura).

b. Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore

Nga verifikimi i evidencës së vendimeve gjyqësore rezultoi se gjatë vitit 2025 Bashkia ka administruar detyrime të konsiderueshme që burojnë nga vendime gjyqësore të formës së prerë. Në fillim të vitit ushtrimor rezultuan detyrime të prapambetura në vlerën 8,365,724 lekë, ndërsa gjatë vitit janë paraqitur për ekzekutim 10 vendime të reja gjyqësore në vlerën 20,242,080 lekë. Në total, detyrimet për t'u likuiduar gjatë vitit janë në vlerën 28,607,804 lekë. Gjatë vitit 2025 janë kryer pagesa në vlerën 26,665,709 lekë, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur ende të pashlyera detyrime në vlerën 1,942,095 lekë. Peshën kryesore të detyrimeve e zënë vendimet gjyqësore për përfitimin e pensionit të invaliditetit, në vlerën 15,709,193 lekë, si dhe detyrimet për dëmshpërblim page ndaj punonjësve të larguar nga puna. Krijimi dhe mbartja e vazhdueshme e detyrimeve që burojnë nga vendime gjyqësore tregon se njësia nuk ka arritur të minimizojë kostot financiare që rrjedhin nga konfliktet administrative dhe marrëdhëniet e punës, duke sjellë ngarkesë shtesë mbi fondet publike dhe duke kufizuar mundësinë e përdorimit të tyre për qëllime të tjera buxhetore. Këto veprime janë në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, pika 60. Në tabelën e mëposhtme gjenden të dhënat mbi vendimet gjyqësore

Tabela nr. 10 *Në lekë*

Numri i vendimeve gjyqësore-si çelje me 01.01.2024	Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje me 01.01.2025	Numri i vendimeve gjyqësore te ardhura ne finance gjate vitit 2025	Vlera e vendimeve gjyqësore te ardhura ne finance gjate vitit 2025	Pagesa ne leke te kryera gjate vitit 2025	Detyrimi ne leke me 31.12.2025
Demshpeshblim page për punonjësit e larguar nga puna	6,409,612	3	1,718,239	6,895,078	1,232,773
Dëmshpërblim pension invaliditeti	-	6	15,709,193	15,709,193	-
Vendime te tjera gjyqësore	1,956,112	1	2,814,648	4,061,438	709,322
Total	**8,365,724**	**10**	**20,242,080**	**26,665,709**	**1,942,095**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, sektori i financës*

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (*të akumuluara*) në fund të vitit 2025 paraqiten në vlerën 128,424,391 lekë dhe pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 8.34% kundrejt fondeve faktike. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2025 paraqiten në vlerën 105,602,353 lekë dhe pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 8.34% kundrejt fondeve faktike.

Tabela nr. 11 *Në lekë*

NR	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	**Borxhe (a+b)**	**0**		
a	**Hua afatgjatë**	**0**		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a,2	Titujtëemetuar			
a,3	Garancipërtëtretë			

b	**Hua afatshkurtër**	**0**		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b,2	Titujtëemetuar			
b,3	Garancipërtëtretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**105,602,353**		**8.34%**
Llogaria ekonomike	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqesore	1,942,095		
4864200	Det.Prap. Sherbime	6,363,360		
4864201	D.P.Energji Elektirke	584,697		
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	133,200		
4864400	Det.Prap. Investime	63,463,364		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH	**0**		
4864600	Mallra	32,239,221		
4864900	Det.Prap.TeTjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore	613,891		
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	**252,644**		
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.TatimeTjera	9,881		
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	**Totali (I+II)**	**105,602,353**	**1,266,726,675**	**8.34%**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike sektori i financës*

2.2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.

Në zbatim të Nënpikës nr. 2.6, të Programit të Auditimit nr. 551/1 prot., datë 22.05.2026, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Vendimi i Këshillit Bashkiak Dibër për miratimin e paketës fiskale.
2. Rregullorja e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit.
3. Struktura organizative.
4. Dokumentacion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim paguesve.
5. Kontrata, akt-marrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat.
6. Regjistrimi dhe mbajtja e debitorëve për bizneset dhe familjarët për taksat dhe tarifat vendore.
7. Analiza mbi planifikimin e të ardhurave për vitin 2025.
8. Realizimi i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara.
9. Dokumentacion në lidhje me Agjentët Tatimorë, rakordimet me ta dhe me Degën e Thesarit etj.,.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

1. Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Struktura organizative e Bashkisë Dibër e aplikuar për vitin 2025 është miratuar me VKB nr. 66, datë 11.12.2024, "Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2025" dhe konfirmuar nga prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 1059/1, datë 20.12.2024. Ky vendim është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Dibër me Vendimin nr. 05.01.2025, "Për Miratimin e Strukturës Organike të Bashkisë Dibër për vitin 2025". Në këtë strukturë përfshihet edhe Drejtoria e Taksave e cila përbërë nga 9 (nëntë) pozicione pune si më poshtë:

Tabela Nr. 12. Struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2025.

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE		
NR.	**EMER MBIEMER**	**POZICIONI**
1	F. R.	Drejtor
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË TË ARDHURAVE		
2	B. M.	Përgjegjës Sektori
3	M. Gj.	Specialist i Licensimit
4	E. P.	Specialist planifikimit të ardhurave
5	O. I.	Specialist i rakordimit të tatim-taksave
6	M. H.	Specialist i hedhjes së të dhënave në sistem
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE KONTROLLIT		
7	A. T.	Përgjegjës sektori
8	K. P.	Specialist terreni per taksat/ tarifat vendore
9	A. B.	Specialist terreni per taksat/ tarifat vendore
2 PUNONJËS SEZONAL		
10	B. S.	Specialist terreni per taksat/ tarifat vendore
11	E. H.	Specialist i mbledhjes borxhit

Burimi i të dhënave: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore

2. Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Dibër për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, është miratuar me Vendim nr. 65, datë 11.12.2024, "Për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Dibër për vitin 2025". Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Dibër për vitin 2025 paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë: *(Tabela mbi planifikimin dhe realizimi e të ardhurave për vitit 2025, Bashkia Dibër në Aneksin nr. 1)*

Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **300,000 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **205,011 mijë lekë** referuar Akt-Rakordimit me Degën e Thesarit Dibër ose në masën **68%** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **94,989 mije lekë.**

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

a. "Takse Autorizimi(karburante ,lende gazi)" është planifikuar në vlerën 2,600 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,900 mijë lekë ose realizuar në masën 227%.
b. "Renta Minerare" është planifikuar në vlerën 80 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 206 mijë lekë ose realizuar në masën 116%.
c. "Të tjera taksa dhe Tarifa" është planifikuar në vlerën 28,100 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 40,261 mijë lekë ose realizuar në masën 143%.

Por referuar të dhënave të sipërpërmendura disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

a. "Tatim Thjeshtuar mbi Fitimin" është planifikuar në vlerën 6,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 402 mijë lekë ose realizuar në masën 7%.
b. "Taksa e ndikimit në infrastrukturë" është planifikuar në vlerën 63,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 9,660 mijë lekë ose realizuar në masën 15%.
c. "Taksa e fjetjes ne Hotel" është planifikuar në vlerën 7,200 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,147 mijë lekë ose realizuar në masën 16%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon

negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.
Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.
Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë viteve paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.
Në këtë konteks është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Dibër që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015,
datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200.

3. Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit të aplikuar për vitin 2025 nga Bashkia Dibër, miratuar me vendimin nr.120 prot., datë 28.05.2025, nga Kryetari i Bashkisë me objekt *"Miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Dibër dhe të Njësive Administrative",* nuk është caktuar personi përgjegjës i cili ka për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt-rakordimeve me ta.
Të ardhurat nga agjentët tatimorë (ASHK për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme; Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale, DSHTRR Dibër në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura si dhe Ujësjellës Kanalizime Sh.A., në lidhje me Taksa e pronës dhe Tarifat e familjarëve) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Dibër dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit duke kuadruar me akt-rakordimin e të ardhurave. Të ardhurat e arkëtuara nga agjentët tatimorë për vitin 2025 paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Tabela Nr.13. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitit 2024 nga agjentët tatimore. *lekë*

Nr.	Emërtimi	Plani 2025	Realizimi 2025	%
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (DRT)	6,000,000	402,367	7
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (DRT)	20,000,000	31,190,721	156
3	Taksa Vjetore Mjeteve Përdorura (DSHTRR)	35,000,000	34,301,404	98
4	Taksa mbi Transaksionet e Pasurive të. Paluajtshme (ASHK)	600,000	366,377	61
5	Taksa e Rentës Minerale (DRT)	80,000	206,834	259
	Totali	**61,680,000**	**66,467,703**	**107**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore

Për vitin 2025 ndërmjet Drejtorisë së Tatim Taksave, Bashkia Dibër dhe agjentëve tatimorë nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore me përjashtim të agjentit tatimor "Ujësjellës Kanalizime Sh.A", me të cilin janë bërë çdo muaj rakordime.

Për sa trajtuar më sipër Bashkia Dibër i referohet vetëm vlerave të arkëtuara nga agjentët tatimorë sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit, por nuk ka një bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimorë dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Dibër, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore", neni 117, ku përcaktohet që "Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave". Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, "Për taksat kombëtare".

4. Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizikë/juridikë dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Dibër kryhet në programin Excel.

Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore për abonentë familjarë nuk disponon regjistra fizik. Kjo Drejtori gjatë vitit 2025 ka hartuar regjistrat në programin Exel për të gjitha Njësitë Administrative për abonentët familjarë.

Për abonentët familjarë, mbledhja e taksave dhe tarifave vendore kryhet nga agjenti tatimor "Ujësjellës Kanalizime Sh.A", me përjashtim të Njësisë Administrative Maqellare, Njësisë Administrative Selishte, Njësisë Administrative Lurë, Njësisë Administrative Zall Dardhë dhe Njësisë Administrative Reç. Për këto Njësi Administrative, në strukturën organizative të çdo njësie ka një punonjës për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjarë.

Sipas VKB nr. 65, datë 11.12.2024 janë përjashtuar nga pagesa e taksave dhe tarifave, pensionistët e vetëm, personat me aftësi të kufizuar të cilët përbëjnë 624 familje.

Personat të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike janë të përjashtuar nga taksa e pronës si dhe nga tarifa e ndriçimit dhe këto përbëjnë 543 familje.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për Sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: "Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar".

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se gjatë vitit 2025, Bashkia Dibër ka akt-marrëveshje që nga viti 2023 me nr. 3773 prot., datë 04.10.2023 me "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër Sh.A", për taksat dhe tarifat vendore sipas paketës fiskale për abonentët familjarë. Bashkisë Dibër i bëjnë pagesat në bankë në zyrën e Postës Shqiptare ose në arkën e Bashkisë Dibër.

Menaxhimi i borxhit

Abonentët familjarë në Bashkinë Dibër dhe në Njësitë Administrative tariforen me taksa dhe tarifa vendore në bazë të VKB nr. 65, datë 11.12.2024, "Për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Dibër për vitin 2025".

Njoftimet për taksat dhe tarifat vendore përgatiten nga Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër, brenda muajit prill të vitit fiskal. Njoftimet dorëzohen dorazi dhe me postë për shkak të volumit të lartë të abonentëve familjarë. Abonentët debitorë paguajnë pranë arkave të zyrave të njësive administrative.

Abonentët debitorë familjarë janë njoftuar me formularin *"Njoftim dhe Kërkesë për të Paguar (aneksi A - Formulari MSh001), kur taksapaguesi nuk ka paguar në afat detyrimet e tij, lidhur me taksat e tarifat vendore", në përputhje me Udhëzimin e përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore".*

Pasi kanë kaluar 10 (dhjetë) ditë pune nga dërgimi i dokumentit të "*Njoftim dhe Kërkesë për të paguar*" nga titullari i NJVV duhet të nxirret urdhri i bllokimit. Nga Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dibër është vepruar në kundërshtim me *Udhëzimin e përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore" pika 2, urdhri bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesit.*

Abonentët familjarë debitorë në njësitë administrative dhe në qytetin e Dibër paraqiten në fund të vitit 2024 për vlerën **53,139,417 lekë**. Gjatë vitit 2025 vlera e debitorëve të rinj të krijuar është **4,333,810 lekë**. Detyrimi total progresiv në fund të vitit 2025 është në vlerën **57,473,227 lekë** nga taksat dhe tarifat për abonentët familjarë. **Ky borxh tatimor është i pakontabilizuar.**

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore".

Tabela nr. 14: Detyrimet e familjarëve sipas taksave dhe tarifat vendore dhe numrit të familjeve debitore të vitit ushtrimor 2025 si vijon:

Lekë

Nr.	Emërtim taksës/tarifës vendore	Detyrimi deri 31.12.2024	Vlera e debitorëve të rijnë, krijuar vetëm gjatë vitit 2025	Detyrimi progresiv i debitorëve më 31.12.2025	Numri i familjeve debitore
1	Taks ndërtesë	10,757,828	230,309	10,988,137	**3963**
2	Taks toke bujqësore	17,632,869	1,234,642	18,867,511	
3	Takse trualli, pastrim, ndriçim,	24,748,720	2,868,859	27,617,579	
TOTALI		**53,139,417**	**4,333,810**	**57,473,227**	

Burimi i të dhënave: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore

Informacioni për situatën debitorë në Bashkinë Dibër paraqitet me rezerva për shkak:

1) Bashkia Dibër nuk disponon regjistra fizik për abonentët familjarë e cila sjell mos pasjen e një liste të certifikuar të numrit total të abonentëve familjarë.

2) Për tokën bujqësore nuk disponohet një regjistër për të analizuar ngarkesën fiskale dhe debinë progresive.

Taksa e tokës bujqësore:

Bashkia Dibër për vitin 2025 ka parashikuar të arkëtoi të ardhura nga taksa për tokën bujqësore në vlerën 5,300 mijë lekë ndërkohë që realizimi i kësaj takse për vitin 2025 është në vlerën 1,365 mijë lekë apo 26% të parashikimit.

Sipas të dhënave që disponon Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Bujqësisë në Bashkinë Dibër sipërfaqja totale e tokës bujqësore në administrim të Bashkisë Dibër është 19117 ha. Nga kjo sipërfaqe tokë në pronësi private janë 13104 ha dhe tokë në pronësi shtetërore 6013 ha. Në tabelën e mëposhtme po paraqesim ndarjen e tokës bujqësore në Bashkinë Dibër.

Tabelën nr.15: Paraqitet informacion mbi ndarjes e tokës bujqësore në Bashkinë Dibër.

Nr.	Nj. A.	Toke bujqësore gjithsej (ha)	Toke bujqësore Shtet (ha)	Toke bujqësore në pronësi (ha)
1	Qyteti Peshkopi	160	0	160
2	NJ.A. Tomin	2691	531	2160
3	Nj.A. Melan	1531	234	1297
4	Nj.A. Kastriot	2361	432	1929
5	Nj.A. Lurë	561	296	265
6	Nj.A. Maqellarë	3067	337	2730
7	Nj.A. Muhurr	877	385	492
8	Nj.A. Luzni	923	518	405
9	Nj.A. Selishtë	599	264	335
10	Nj.A. Sllovë	1753	574	1179
11	Nj.A. Kala e Dodës	778	348	430
12	Nj.A. Zall-Dardhë	782	437	345
13	Nj.A. Zall-Reç	712	509	203
14	Nj.A. Fushë Çidhën	1019	387	632
15	Nj.A. Arras	1303	761	542
Shuma		**19117 ha**	**6013 ha**	**13104 ha**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore

Bashkia Dibër nuk disponon regjistra fizik dhe elektronik për abonentët familjarë për taksën bujqësore. Referuar paketës fiskale të Bashkisë Dibër të miratuar me vendimin nr. 65, datë 11.12.2024, "Për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Dibër për vitin 2025", niveli i taksës dhe tarifës është 1,000 lek/ha/vit por nuk ka një arsyetim apo një miratim për përdorimin e këtij niveli për taksën/tarifën e Tokës Bujqësore.

Referuar të dhënave të mësipërme sipërfaqja e ndarë e tokës bujqësore është 3,880 ha x1,440 lek/ha, ngarkesa totale për këtë taksë gjatë vitit 2025 duhet të jetë në vlerën 5,587,200 lekë. Sipas akt rakordimit të të ardhurave nga kjo taksë është arkëtuar vlera 1,349,895 lekë për të cilën nuk kemi informacion të analizuar për cilën periudhë fiskale është arkëtuar kjo vlerë.

Referuar analizës së mësipërme nuk mund të gjenerohet një vlerë totale debie për këtë taksë.

5. Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Bashkia Dibër nuk disponon sistem elektronik për administrimin dhe regjistrimin e taksave dhe tarifave vendore për abonentët private.

Të dhënat e abonentëve privatë janë të regjistruara vetëm në Excel dhe nuk disponohet regjistër fizik në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" neni 7

Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Situata e lëvizjes së subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Dibër bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:

Në **tabelën nr. 16**: Lëvizjet e biznesit gjatë vitit 2025.

Nr.	Lloji Biznesit	Gjendja fillim (2025)	Regjistrime të Reja	Aktivit i mbyllur	Gjendja fund (2025)
1	**Biznesi Vogël**	808	62	18	852
2	**Biznesi Madh**	120	4	0	124
(1+2)	**Gjithsej**	928	66	18	976

Burimi i të dhënave: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore

Nga informacioni i mësipër është kërkuar praktika e mbajtur me QKB për bizneset të cilat kanë aplikuar për mbyllje ose pezullim aktivitetit gjatë vitit 2025 si mëposhtë:

Mënyra e llogaritjes dhe vlerësimi i të ardhurave sipas paketës fiskale abonentët biznes:
Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dibër janë verifikuar regjistrat elektronike për biznesin e madh.
Nga regjistri elektronik u verifikuan të dhënat për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit. Tarifa e pastrimit për biznesin e madh është ngarkuar në përputhje me paketën fiskale të Bashkisë Dibër.

6. Menaxhimi i borxhit nga taksat dhe tarifat vendore:

Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2024, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet si biznes i vogël dhe biznes i madh në vlerën **16,383,076 lekë.** Gjatë vitit 2025 për llogari të detyrimeve që i përkasin debitorëve progresiv deri 31.12.2024 është likuiduar vlera 896,450 lekë si dhe janë krijuar debitorë të rinj për vitin 2025 në vlerën 1,401,130 lekë. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2025, për subjektet biznes i vogël dhe i madh janë në vlerën **16,887,756 lekë. Borxhi tatimor është i kontabilizuar.**

Në tabelën nr. 17: Të dhënat në mënyrë analitike për vitin 2024-2025 paraqiten si mëposhtë: *lekë*

Nr.	Kategoria e taksapaguesit (Debitor)	Çelja 01.01.2025	Pagesat e kryera gjatë vitit 2025 për llogari të gjendjes së debitorëve progresiv në datën 31.12.2024	Vlera e debitorëve të rijnë, krijuar vetëm gjatë vitit 2025, nga mos pagesa e detyrimeve të vitit 2025	Detyrimi progresiv i debitorëve më 31.12.2025
1	Subjektet e mëdha	1,653,248	254,400	0	1,398,848
2	Subjektet e vogla NJ.A. Peshkopi	11,282,782	537,770	1,349,070	12,094,082
3	Subjektet e vogla NJ.A. të tjera	3,447,046	104280	52,060	3,394,826
	TOTALI	**16,383,076**	**896,450**	**1,401,130**	**16,887,756**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore

Në lidhje me këtë situatë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dibër, për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, por në asnjë rast nuk është kërkuar kallëzim penal në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 181 "Mos pagimi i taksës dhe tatimeve". Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, ku përcaktohet që: "Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë

buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore" si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10.

7. Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, deri datë 31.12.2025, detyrimi progresiv që vjen nga kjo taksë është 4,360,122 lekë. Nga auditimi konstatohet se deri më datë 01.01.2025 vlera debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 3,287,903 lekë. Gjatë vitit 2025 janë likuiduar detyrime në vlerën 476,590 lekë por është krijuar debi për taksën e ndikimit në infrastrukturë 1,548,809 lekë. Gjendja debitore në datën 31.12.2025 rezulton në vlerën **4,360,122 lekë.**

Në tabelën e mëposhtme paraqitet detyrimi progresiv i taksës së ndikimit në infrastrukturë deri më 31.12.2025.

Në tabelën nr. 18: Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë: *lekë*

Çelja 01.01.2025		**Detyrimi 31.12.2025**		**Pagesat 2025**		**Detyrimi progresiv 31.12.2025**	
Nr.	**Vlerë**	**Nr.**	**Vlerë**	**Nr.**	**Vlerë**	**Nr.**	**Vlerë**
80	3,287,903	53	1,548,809	12	476,590	121	4,360,122

Burimi i të dhënave: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se nga Bashkia Dibër për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", neni 27, pika "d", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5.

8. Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se përgjatë vitit 2025 në territorin e Bashkisë Dibër dhe njësive administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 15 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre dhe 3 subjekte që tregtojnë vetëm Gaz.

Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2025, gjithsej rezultojnë 3 subjekte të papajisura me autorizim me afat 1-5 vjeçar dhe me një detyrim prej 1,000,000 lekë.

Duhet theksuar se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit si dhe pas kontrolleve në terren nga ana e strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër, ka rezultuar se këto subjekte nuk ushtrojnë aktivitet si dhe statusi tek tatimet, për këto subjekte rezulton jo Aktiv.

Tabela nr. 19: *Të dhënat për subjektet që tregtojnë hidrokarbure paraqiten si më poshtë:*

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	"Sh"	JE	11.05.2025	10.5.2030	1,000,000	1,000,000	0
2	"D"Shpk	KC	01.07.2025	30.06.2030	1,000,000	1,000,000	0
3	"M96" Sh.p.k	JN	23.06.2020	22.06.2025	1,000,000	1,000,000	0
4	"K" Sh.p.k	JP	12.06.2025	11.06.2030	1,000,000	1,000,000	0
5	"K "Sh.p.k	JP	05.03.2025	04.03.2030	1,000,000	1,000,000	0
6	"G C" shpk	KT	24.03.2026	23.03.2031	1,000,000	1,000,000	0
7	"D R" shpk	JB	09.03.2026	08.03.2031	1,000,000	1,000,000	0
8	"S G" shpk	KV	17.06.2020	24.06.2025	1,000,000	1,000,000	0
9	"O" shpk	JI	01.07.2025	30.06.2030	1,000,000	1,000,000	0
10	"K P" shpk	JM	16.09.2026	15.09.2026	1,000,000	1,000,000	0
11	"B" shpk	JJ	16.09.2020	15.09.2022	1,000,000	800,000	200,000
12	"M M" shpk	JJ	19.07.2020	18.07.2022	1,000,000	800,000	200,000
13	"O E "shpk	LK	23.06.2025	22.06.2026	1,000,000	1,000,000	0
14	"H 2014 "shpk	LP	04.10.2020	03.10.2022	1,000,000	400,000	600,000
15	"A" shpk	JH	19.07.2025	18.07.2026	1,000,000	1,000,000	0
16	"T" shpk (Gaz)	KP	16.02.2025	15.02.2030	100,000	100,000	0
17	"I N" shpk (Gaz)	KV	03.08.2020	02.08.2025	100,000	100,000	0
18	R. Xh. (Gaz)	KP	18.03.2026	17.03.2031	100	100,000	0
SHUMA					**15,300,000**	**14,300,000**	**1,000,000**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore

2.3. Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025

2.3.1. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit

2.3.2. Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

2.3.3. Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

<u>Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:</u>

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar; Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar; Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme* "i ndryshuar, si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese;

<u>Hartimi i pasqyrave financiare:</u>

Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Pasqyrat statistikore:

- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Bashkia Dibër ka ne varësi katër institucione K F "K" me NIPT K77009731J, Q B me NIPT J97005702A, dhe Q K me NIPT K46908726N, Klubi Shumë Sportësh Korabi, Peshkopi me NIPT K46908710E. Hartimi i pasqyrave financiare te Bashkisë Dibër kryhet duke përshirë bilancet e këtyre katër institucioneve.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

- Pasqyrat financiare të konsoliduar Bashkia Dibër, janë të firmosura nga Kryetari i Bashkisë z. R. S, (Nëpunësi Autorizues) si dhe hartuesi i llogarive, znj. Ç. Z, (Nëpunësi Zbatues) me shkresën nr. 2033.prot., datë 12.05.2026 dhe konfirmuar nga thesari me shkresën nr. 175/1 datë 12.05.2026. Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimit financiar janë Akt rakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Dibër të konfirmuara dhe nënshkruara nga Nëpunësi Zbatues znj. Ç. Z, si dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit, Dibër.

Pasqyrat financiare janë hartuar jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, *"Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* pika 118. ''*Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit''.*

Konkluzion: *Nga auditimi u konstatua që Pasqyrat Financiare janë hartuar dhe dërguar ne Degën e Thesarit Dibër me shkresën nr. 2267.prot., Datë 08.04.2026 dhe konfirmuar nga thesari datë 08.04.2026 jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 118.*

3.1. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, arkën, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj., të cilat mbahen dhe përpunohen në format Excel.

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin e rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2025 ka marrë në konsideratë vlerën e precizonit 14,123 mijë lekë për shpenzimet.
Bazuar në vlerën e materialitetit të përllogaritur prej 14,123 mijë lekë nga ana e grupit të auditimit u krye verifikimi me zgjedhje për urdhër shpenzimet e periudhës 01.01.2025 deri në 31.12.2025.
Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*" për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumentet vërtetues, Dokumentet e kontabilitetit, etj.

Procesi i inventarizimit:
Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se;
Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 530, date 17.11.2025, *"Për ngritjen e komisionit për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe Qarkulluese për vitin 2025"*, në secilën njësi administrative është ngritur komisioni për të kryer inventarizimin fizik të aktiveve në përdorim, si dhe për të krahasuar gjendjen konkrete të aktiveve me gjendjen kontabël, me anëtarë për Bashkinë Dibër dhe Njësitë e varësisë. Në *aneks* paraqesim ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese për vitin 2025.
Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve/ shtesat/ pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në pasqyrën nr. 7/a, "*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)*", pasqyrën nr. 7/b, "*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)*", kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-daljet nga magazina etj.
Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit për vitin 2025, sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 530, date 17.11.2025, *"Për ngritjen e komisionit për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe*

Qarkulluese për vitin 2025" dhe vlerësimin e aktiveve te qëndrueshme për periudhën janar – dhjetor 2025, përkatësisht në shkolla, kopshte, çerdhe, Bashki dhe Njësi Administrative, për llogaritë financiare si me poshtë:
-llogaria 214 ''Instalime teknike, makineri e pajisje'
-llogaria 218 ''Inventar ekonomik'
-llogaria 32 ''Objekte inventari'
Nga Drejtoria Ekonomike është hartuar përmbledhëse e inventarëve për llogaritë sa më sipër për të cilat nga komisionet e inventarizimeve janë konstatuar për jashtë përdorimit sipas llogarive si më poshtë:

Tabela nr. 20: Asetet për nxjerrje jashtë përdorimi *Lekë*

Përmbledhëse aseteve për nxjerrje jashtë përdorimi					
Nr.	**Nj. A.**	**Llog 214 Viti 2025**	**Llog 218 Viti 2025**	**Llog 327 Viti 2025**	**Totali**
1	Arras		249,215	31,740	280,955
2	Fushe -Cidhen		72,500	15,770	88,270
3	Kala E Dodes		281,220	50,440	331,660
4	Kastrioti	307,000	222,268	24,900	554,168
5	Lura		86,800	171,800	258,600
6	Luzni	600	323,833	149,340	473,773
7	Maqellare	708,434	1,005,507	192,592	1,906,533
8	Melan	553,580	1,722,521	1,044,648	3,320,749
9	Muhur	4,000	379,060	24,300	407,360
10	Selishte	5,388	278,696	93,220	377,304
11	Sllove	683,444	2,200	70,582	756,226
12	Tomin	117,646	312,955	24,370	454,971
13	Zall -Dardhe		40,600	22,400	63,000
14	Zall-Rec		122,059	61,056	183,115
15	Peshkopi	1,654,593	1,208,544	86,123	2,949,260
	TOTALI	**4,034,685**	**6,307,978**	**2,063,281**	**12,405,944**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Për vitin 2025 Bashkia Dibër nuk ka procedurë për nxjerrje jashtë përdorimit.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se është kryer inventarë fizik për llogarinë 31 "Materiale", llogarinë 32 "Inventarë i imët", llogarinë 214 " Instalime teknike Makineri pajisje" llogarinë 215 "Mjete transporti", llogarinë 214 " Instalime teknike Makineri pajisje" dhe llogarinë 218 "Inventarë ekonomik" ndërsa për llogaritë e tjera të Aktiveve Afatgjata Materiale nuk është kryer inventarë fizik si rrjedhojë pasqyrat financiare përmbajnë vetëm vlerat kontabël të tyre, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket llogarive në fund të vitit, veprime në shkelje të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat; 74, 77, 83, 85/a, b, 86, 95, UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Kreu III, pika 30, i ndryshuar.

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2025

A. AKTIVET

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ,gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2025, të pozicionit financiar të Bashkisë Dibër, formati nr. 1 është paraqitur më poshtë:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1).

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 5,880,711,131 lekë.

- Aktivet 6,359,841,803 lekë
- Detyrimet 479,130,672 lekë
- Aktivet Neto 5,880,711,131 lekë

Aktivet afatshkurtra:

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën 671,380,828 lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 204,723,227 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 38,793,315 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 287,211,920 lekë
- Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të tjera aktive afatshkurtra" në shumën 140,652,366 lekë

Tabela 21: Aktivet e paraqitura ne pasqyrën e pozicionit financiar *Lekë*

Nr.	Referenca Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	A	A K T I V E T	6,359,841,803	6,358,727,085
2		I.Aktivet Afat shkurtra	671,380,828	642,834,767
3		1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre	204,723,227	175,611,558
4	531	Mjete monetare ne Arke	0	0
5	512,56	Mjrete monetare ne Banke	0	0
6	520	Disponibilitete ne Thesar	164,761,027	159,156,358
7	50	Letra me vlere	0	0
8	532	Vlera te tjera	39,962,200	16,455,200
9	54	Akreditiva dhe paradhenie	0	0
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)	0	0
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	34,405,537	32,004,543
12	31	Materiale	12,172,068	18,067,880
13	32	Inventar I imet	19,841,360	12,333,530
14	33	Prodhim nre proces	0	0
15	34	Produkte	0	0
16	35	Mallra	2,392,109	1,603,133
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri	0	0
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve	0	0
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit	0	0
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)	0	0
21		3.Llogari te Arketushme	265,160,061	230,408,879
22	411	Kliente e llogari te ngjashme	0	0
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	5,880,928	5,880,928
24	431	Tatim e Taksa	0	0
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal	0	0
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti	0	0
27	435	Sigurime Shoqerore	0	0
28	436	Sigurime Shendetsore	0	0
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore	0	0
30	44	Institucione te tjera publike	0	0
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere	0	0
32	468	Debitore te ndryshem	104,232,216	101,944,016
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	155,046,917	122,583,935
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike	0	0
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)	0	0
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	128,424,391	165,433,833

37	409	Parapagime	0	0
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin	0	0
39	477	Diferenca konvertimi aktive	0	0
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime	0	0
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	128,424,391	165,433,833

Burimi: Drejtoria Ekonomike

1. Llogaritë e klasës 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" paraqitet ne fund te vitit 2025 në vlerën 204,723,227 leke dhe përbëhen nga:

Tabela nr. 22:Llogaritë e klasës 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre". *lekë*

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Ndryshimi
520	Disponibilitete ne Thesar	164,761,027	159,156,358	5,604,669
532	Vlera të tjera	39,962,200	16,455,200	23,507,000
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre		**204,723,227**	**175,611,558**	**29,111,669**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Nga auditimi i te dhënave te pasqyrave te pozicionit financiar u konstatua qe llogaria (520) *"Disponibilitete në thesar"* është paraqitur ne fund te të vitit 2025 në shumën 164,761,027 lekë. Llogaria 520 *"Disponibilitete në thesar"*. Teprica e llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"* duhet të rakordoje me akt rakordimet me thesarin për gjendjen e fondeve të pa përdorura që ndodhen në thesar si dhe gjendjen në thesar të llogarisë 466 "*kreditorë në ruajtje".* Nga auditimi i të dhënave të akt rakodimeve me thesarin u konstatua që fonde të pa përdorura sipas rakordimit me thesarin me date 31.12.2025 janë në vlerën 101,266,666 leke dhe llogaria 466 "*Kreditorë në ruajtje" sipas* pasqyrës se pozicionit financiar është ne vlerën 63,494,361 leke. Totali i fondeve të pa përdorura plus llogaria 466 "*Kreditorë në ruajtje" (*101,266,666 leke + 63,494,391 leke = 164,761,027 lekë), pra nuk kemi diferencë me Llogarinë 520 *"Disponibilitete në thesar"* = 164,761,027 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash floë Formati nr. 3 u konstatua se "*Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor"* është paraqitur në vlerën 204,723,227 lekë, vlerë e cila përputhet me llogarinë "Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre" që në rastin konkret është llogaria 520 *"Disponibilitete në thesar"* 164,791,225 lekë + *llogaria 532* "*Vlera te tjera"* 39,793,315 = 204,723,227 lekë.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grande të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

- Llogaria 31 "Materiale", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 23 *Lekë*

Llogaria 31 "Materiale"	
Çelje e vitit 2025	18,067,880
Shtesa (D)	53,934,575
Pakësime (K)	59,830,387
Gjendja debitore në 31.12.2025	12,172,068

Burimi: Drejtoria Ekonomike

- Llogaria 32 "Inventar i imët", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 24 *Lekë*

Llogaria 32 "Inventar i imët"	
Çelje e vitit 2025	12,333,530
Shtesa (D)	7,507,830
Pakësime (K)	0

Gjendja debitore në 31.12.2025	19,841,360

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Shtesat prej 7,507,830 lekë përfaqësojnë objekte inventari të ardhura nga ministria e Arsimit dhe si rrjedhojë duhet të ishin shtesë e llogarisë 31 "Materiale", Në mbyllje të bilancit 2026 të bëhet sistemimi I këtyre llogarive.

Nga auditimi i pasqyrës të aneksit statistikor te flukseve monetare Cash floë Formati nr.3 u konstatua se "Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente" është paraqitur në vlerën (954,708,531) lekë. Sipas situacionit të shpenzimeve të thesarit "shpenzime korente" janë në vlerën 954,708,531 lekë, pra janë paraqitur në pasqyrën Cash Floë pa diferenca. Të dhënat e situacionit të shpenzimeve sipas thesarit për "Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente" janë si me poshtë vijon:

Tabela nr. 25: Shpenzimet buxhetore sipas akt rakordimit me thesarin *lekë*

Llogaria ekonomike	Emërtimi i llogarisë	Buxheti faktik 2025
600	"Pagat dhe përfitimet e punonjësve".	684,435,238
601	"Kontribute për sigurimet shoqërore e shëndetësore"	112,696,249
602	"Blerje mallrash e shërbimesh të tjera"	142,195,195
604	"Transferime korrente të brendshme".	300,000
606	"Transferta për buxhetet familjare dhe individët"	7,301,026
466	Pagersa per mjete ne ruajtje	7,780,823
	Totali	**954,708,531**

Burimi: Drejtoria e Ekonomike

Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" ne fund te vitit 2025 paraqiten ne vlerën 265,160,061 leke me një ndryshim në shtesë nga viti i kaluar në vlerën 34,751,182 leke.

Tabela nr. 26: Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" *lekë*

		2025	**2024**	**Ndryshimi**
Llogaria	**Llogari te Arketushme**	265,160,061	230,408,879	34,751,182
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	5,880,928	5,880,928	0
468	Debitorë te ndryshëm	104,232,216	101,944,016	2,288,200
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	155,046,917	143,232,294	32,462,982

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Llogaria 423-429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* paraqitet ne fund te vitit 2025 në vlerën 5,880,928 leke dhe është e njëjtë krahasuar me vitin 2024.

Llogaria 468 "Debitorë te ndryshëm" në vitin 2025 paraqitet në vlerë 104,232,216 lekë dhe ka pësuar një rritje prej 2,288,200 lekë në krahasim me vitin 2024 ku paraqitet me vlerën 101,944,016 lekë. Të analizuara paraqiten në *Aneks.*

<u>Konstatimi</u>: Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 104,232,216 lekë. Nga verifikimi i kryer rezulton se në debi të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", nuk janë përfshirë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve për vlerën 4,360,122 lekë dhe debitorët familjarë në vlerën 57,473,227 lekë, për një total prej 3963 familje. Pra rezulton se nuk janë përfshirë një total prej gjithsej në vlerën 61,833,349 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu III. "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 30.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 155,046,917 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës 4 të Pasivit, si më poshtë:
- Detyrime për paga ndaj personelit të pasqyruara në llog.(42) “Detyrime ndaj personelit” në vlerë 49,164,911 lekë.
- Detyrime për sigurime shoqërore pasqyruar llog.(435) ”Sigurime shoqërore” në vlerë 14,619,045 lekë.
- Detyrime për sigurime shëndetësore të pasqyruara në llog.(436) “Sigurime shëndetësore” në vlerë 2,022,516 lekë.
- Detyrimet ndaj shtetit për tatime e taksa të pasqyruara në llog.(431) “Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa” në vlerë 3,721,012 lekë.
- Detyrime ndaj furnitorëve të pasqyruara në llog.(401-408)“Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerë 85,519,433 lekë, për fatura të cilat nuk kanë mbushur afatin 60 ditor për likuidim.
Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 155,046,917 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës 4 të Pasivit për paga, sigurime, tatime dhe furnitorë të ndryshëm, e cila kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare, e cila paraqitet në vlerën 155,046,917 lekë, veprime këto në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32.

Llogaria (486) “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”, ne pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2025 në vlerën 128,424,391 lekë. Por sipas ndryshimeve të Udhëzimit nr. 8 të Ministrisë së Financave, regjistrimet e Thesarit në llogarinë 486 nuk duhet të paraqiten si pjesë e Pasqyrës së Pozicionit Financiar (Bilancit) të prodhuar nga sistemi SIFQ.

*Konstatimi: Për këtë arsye, që kjo llogari nuk duhet të kontabilizohet në bilanc si aktiv ose pasiv, veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, ““Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 15, “Degët e Thesarit regjistrojnë në SIFQ raportin/listën e faturave të siguruar sipas pikës 6 (b) të këtij udhëzimi lidhur me detyrimet e prapambetura të njësive të qeverisjes së përgjithshme ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara për shkak të mungesës së fondeve publike. Për të evidentuar këto detyrime, degët e thesarit përdorin llogarinë kontabël 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", funksionimi i të cilit caktohet me udhëzim të veçantë dhe vetëm për qëllime monitorimi të performancës financiare të njësive të qeverisjes përgjithshme. Regjistrimet e thesarit në llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese, ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me këto të fundit.**”**(paragrafi 15, pika 3.1, Kreu III)***

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 27 *Lekë*

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2025	101,944,016
Shtesa (K)	21,302,380
Pakësime (D)	19,014,180
Gjendja debitore në 31.12.2025	104,232,216

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Tabela nr. 28: Ju lutem plotësoni tabelën e mëposhtme për debitorët llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"

Lekë

Numri i debitorëve	Debitorë subjekte dhe individë	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
	Debitorë nga KLSH	1,819,728			1,819,728
	Debitorë nga APP	1,250,000			1,250,000
	Debitorë nga KLSH	4,201,092			4,201,092
	Debitorë nga KLSH	7,104,359			7,104,359
	Debitorë taksa vendore institucione buxhetore	889,140			889,140
	Debitorë subjektet e mëdha 31.12.2019	1,653,248	0	254,400	1,398,848
	Debitorë KLSH	58,710,570			58,710,570
	Debitorë subjekte e vogla NJA Dibër	11,282,782	1,349,070	537,770	12,094,082
	Debitorë subjekte e vogla NJA Maqellarë	3,447,046	52,060	104,280	3,394,826
	Lista e debitorit subjekte VIP NJA Selishte				
	Debitorë institucione buxhetore taksa vendore				
	Debitorë për tarifat e kopshteve sipas grupeve	2,006,020	11,958,250	11,403,230	2,561,040
	Debitorë për tarifat e çerdheve sipas grupeve				
	Lista e debitorit te letrave me vlere	9,580,031	7,943,000	6,714,500	10,808,531
Totali		**101,944,016**	**21,302,380**	**19,014,180**	**104,232,216**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Aktivet Afatgjata jo materiale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 *"Aktivet Afatgjata Jo materiale",* përbëhen nga llog. 202 "*Studime dhe kërkime*", në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën prej 31,333,653 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2025 paraqiten në vlerë 26,633,605 lekë, që do të thotë se ka pësuar një ulje prej 4,700,048 lekë. Gjithashtu sipas Formatit 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024, paraqitet në vlerën 65,526,270 lekë si dhe në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në të njëjtën vlerë 65,526,270 lekë.

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

Llogaria 210 *"Toka, troje Terrene"*, paraqitet me vlerë neto dhe kosto historike si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 28,394,404 lekë, e cila analizohet si me poshtë:

Tabela nr. 29: *lekë*

Toka, troje, terrene (kosto historike)	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Objekte inventari	28,394,404	0	0	28,394,404
Totali	**28,394,404**	**0**	**0**	**28,394,404**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Llogaria 211 *"Pyje, Plantacione"*, paraqitet me vlerë neto dhe kosto historike si në mbyllje të vitit 2024 ashtu edhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,268,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e pemëve dhe fidanë dekorativ e cila paraqitet si më poshtë;

Tabela nr. 30: *lekë*

Pyje, plantacione (kosto historike)	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Objekte inventari	1,268,000	0	0	1,268,000
Totali	**1,268,000**	**0**	**0**	**1,268,000**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Konstatime: Nga auditimi ka rezultuar se për asetet të transferuara me VKM nr.1533, datë 19.11.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peshkopi, qarku Dibër"; VKM nr.1179, datë 20.08.2008 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në Komunën M.n, të qarkut të Dibrës"; VKM nr. 1001 datë 10.12.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen

në pronësi ose në përdorim të Komunës Arras, të qarkut të Dibrës". Nuk ka informacion sa prej tyre janë të pajisura me certifikatë pronësie , sa nga këto asete janë pjesë e inventarit kontabël, nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i tyre, me komision të ngritur nga titullari i njësisë vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85.

Gjithashtu në llog. (211) "Pyje, kullota, plantacione", nuk është pasqyruar vlera e pyjeve e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Dibër me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", pika 8, shtojca nr. 6 me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Dibër, me nr. nga 1(një) deri 2327 (dymijë e treqind e njëzet e shtatë). Sipas këtij vendimi Bashkia Dibër ka në pronësi gjithsej 36,662 ha nga të cilët 25,351 ha pyje; 5,412 ha kullota, 534 ha sipërfaqe me bimësi pyjore, 3,417 ha sipërfaqe in produktivë, 1,889 ha sipërfaqe djerr dhe 57 ha sipërfaqe ujore kjo llogari nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore. Veprim në mospërputhje me UMF nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2 klasa 2, nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve e Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit. Llog. (211) "Pyje, kullota, plantacione" nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" dhe UMFE nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kap IV, pikat 74, 96, UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap.II, pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", pika 30, UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Llogaria 212 *"Ndërtesa konstruksione"*, ne aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën prej 865,902,470 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 909,104,118 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024, paraqitet në vlerën 1,491,253,472 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 1,579,968,109 lekë.

Gjatë vitit kjo llogari është shtuar në vlerën 88,714,637 lekë, si rezultat:

Tabela nr. 31: *lekë*

Shtesat Llogaria 212		
1	Ndërtimi I tregut agroushqimor , Peshkopi	22,973,627
3	Rikonstruksion shkolla Irfan hajrullai	55,881,983
3	Rikonstruksion I shkollës 9 vjeçare te fshatit Dohoshisht	9,859,027
	Totali	**88,714,637**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Tabela nr. 32: *lekë*

Ndërtesa e konstruksione (kosto historike)	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Objekte inventari	1,491,253,472	88,714,637	0	1,579,968,109
Totali	**1,634,736,952**	**88,714,637**	**0**	**1,579,968,109**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

<u>Konstatimi</u>; Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 212 "Ndërtesa Konstruksione" sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 1,634,736,952 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 1,723,451,589 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione "konstatohet se, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë, që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksionit të objekteve, vlera mbikëqyrjes e kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë kosto të mëpasshme duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM-së. Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, në këtë llogari vlera prej 135,940,644 lekë është e pa analizuara me objekte, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, i ndryshuar.

- Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 33: *lekë*

Rrugë rrjete vepra ujore (kosto historike)	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Objekte inventari	5,299,623,284	322,631,070		5,622,254,354
Totali	**5,299,623,284**	**322,631,070**		**5,622,254,354**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Llogaria 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"*, në aktiv të bilancit, në mbyllje të vitit 2024, paraqitet në vlerën 4,001,949 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2025 pasqyrohet ne vlerën 4,116,417,586 lekë. Sipas Formatit 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 5,299,623,284 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 5,622,254,354. Gjatë vitit kjo llogari është shtuar në vlerën 322,631,070 lekë, si më poshtë vijon;

Tabela nr. 34: *lekë*

Shtesat llogaria 213	
Ndertimi I linjës se furnizimit me uje te pijshem Gurra e Eperme Luzni	246,658,650
Kolaudim punimesh per objektin furnizim me uje nga burimi I Grames per ujesjellesin e Peshkopise Faza I	312,000
Mbikqyrje punimesh per objektin :Sistemim asfaltim I rruges se fshatit Tomin , NJA Tomin Bashkia Diber	276,158
Mbikqyrje punimesh per objektin :Sistemim asfaltim I rruges se lagjes Vraniçe dhe sistemim I sheshit te pallatit , Bashkia Diber , viti 2021	260,468
Rehabilitim dhe shtrimi me asfaltobeton te rruges se fshatit Brezhdan	31,100,989
Sherbim mbikqyrje e punimeve be objektin Ndeërtimi I linjës se furnizimit me uje te pijshem Gurra e Eperme-Luzni-Peshkopi	3,087,499
Shtrim I rrjetit te ri te ujesjellesit te fshatit Selane , financim viti 2025	1,971,000
Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Brest i Eperm , financimi viti 2024 , situacion nr.1 likujdim pjesor	10,555,920
Sistemim asfaltim rruga e fshatit Burim , financimi viti 2025	7,780,470
Sistemim asfaltim rrugeve te brendshme lagja Gjone NjA	360,000
Sistemim kunetash per rrugen e lagjes Kamen	886,800
Rehabilitimi dhe ndertimi i kanaleve vaditese	19,181,724
Sistemim asfaltim rruga e fshatit Burim , financimi viti 2025	199,392
Totali	**322,431,678**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

<u>Konstatimi</u>; Sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 5,299,623,284 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 5,622,254,354.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore "konstatohet se, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë, që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksionit të objekteve, vlera mbikëqyrjes e kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë kosto të mëpasshme duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM-së, nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, në këtë llogari vlera prej 41,330,544 lekë është e pa analizuara me objekte, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin MFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, i ndryshuar.

<u>Konstatimi</u>: Nga auditimi ka rezultuar se në llogarinë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, vazhdon pa e zbritur vlerën për 86 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve në vlerën 1,821,675,198 lekë, që sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" që duhej transferuar në Ujësjellës Kanalizime Dibër, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Gjithashtu për këto objekte, me anë të VKB nr. 38, datë 03.09.2025, "Për transferimin e 86 objekteve në pronësi të Ujësjellës Kanalizime Dibër", është miratuar kalimi në pronësi të Ujësjellës Kanalizime Dibër por deri në mbyllje të vitit 2025 nuk është zbritur vlera 1,821,675,198 lekë për 86 objektet që duhet të transferohen në pronësi të Ujësjellës Kanalizime Dibër sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura"
Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022,Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.
Gjendje e kësaj llogarie e analizuara paraqitet sipas pasqyrës në Aneks, bashkëlidhur, Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 35: *lekë*

Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune (kosto historike)	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Objekte inventari	49,974,070	2,106,301	2,106,301	49,974,070
Totali	**49,974,070**	**2,106,301**	**2,106,301**	**49,974,070**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Llogaria 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune",* në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën prej 43,974,334 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në të njëjtën vlerë 35,179,467 lekë. Sipas Formatit 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet*

e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 47,974,070 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në të njëjtën vlerë 47,974,070 lekë pasi shtesat dhe pakësimet kanë të njëjtën vlerë 2,106,301 lekë dhe paraqiten si vijon;
Blerje vegla pune në vitin 2024 për vlerën 2,106,301 lekë dhe shlyerje fature në vitin 2025 për vlerën 2,106,301 lekë.
- Llogaria 215 "Mjete transporti", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 36: *lekë*

Mjete transporti (kosto historike)	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Objekte inventari	95,402,967	2,939,450	0	98,342,417
Totali	**95,402,967**	**2,939,450**	**0**	**98,342,417**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Llogaria 215 *"Mjete transporti",* në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën prej 47,647,015 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 43,218,954 lekë. Sipas Formatit 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 95,402,967 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 98,342,417 lekë.
Gjatë vitit kjo llogari është shtuar (D) në vlerën 2,939,450 lekë si pasojë;
Blerje makine për vijëzimin e asfaltit për vlerën 520,200 lekë
Mjet Zjarrfikës për vlerën 2,419,250 lekë
Në total 2,939,450 lekë.

- Llogaria 218 "Inventar ekonomik", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 37: *lekë*

Inventar ekonomik (kosto historike)	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Objekte inventari	175,550,573	12,390,039	590,616	187,349,996
Totali	**175,550,573**	**12,390,039**	**590,616**	**187,349,996**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Llogaria 218 *"Inventar ekonomik",* në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 108,614,151 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 97,451,740 lekë. Sipas Formatit 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 175,550,573 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 187,349,996 lekë.
Gjatë vitit kjo llogari është shtuar (D) në vlerën 12,390,039 lekë, dhe pakësuar në vlerën 590,616 lekë si më poshtë vijon;

Tabela nr. 38: *lekë*

Shtesat llogaria 218		
1	Aspirator me 3 nivele	42,600
2	Dyshek	648,000
3	Frigorifer	87,600
4	Karrige	181,260
5	Kondicioner	240,000
6	Sobe Elektrike 6 vatra	552,000
7	Tavoine Druri	128,336
8	Pajisje MOBILERIE AMU+AML	9,425,520
9	EU 4 Inclusive Teaching (Desktop+printer)	494,108
10	Pajisje kompjuterike	590,616
	Totali	**12,390,039**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Tabela nr. 39: *lekë*

Paksimet llogaria 218		
1	Pagesë Blerje pajisje Kompjuterike	590,616
	Totali	**590,616**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Llogaria kontabël 24 *"Aktive te Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara".* Kjo llogari përfaqëson aktive të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorimi nga inventarët e kryera, e cila është deklaruar për vlerën 27,776,781 lekë nga të cilat pajisje kompjuterike në vlerën 4,302,583 lekë që i përkasin llogarisë 218 "Inventarë ekonomik" dhe mjete transporti llogaria 215 "Mjete transporti" në vlerën 23,474,198 lekë që i përket 16 automjeteve të dëmtuara.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria kontabël 24 "Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara", sipas Formatit nr.7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën prej 27,776,781 lekë, të cilat përfaqësojnë pajisje kompjuterike në vlerën 4,302,583 lekë që i përkasin llogarisë 218 "Inventarë ekonomik" dhe mjete transporti llogaria 215 "Mjete transporti" në vlerën 23,474,198 lekë që i përket 16 automjeteve të dëmtuara të evidentuara gjatë viteve 2019-2021, për të cilat nuk është ngritur komision për asgjësimin dhe vlerësimin e si mbeturinë, skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave për Bashkinë Dibër. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 , 85, 109, 110 dhe 111.

- Llogaria 230 "Për aktivet afatgjata jo materiale", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 40: *lekë*

Llogaria 230 "Për aktivet afatgjata materiale"	
Çelje e vitit 2025	40,381,142
Shtesa (K)	5,340,000
Pakësime (D)	0
Gjendja debitore në 31.12.2025	**45,721,142**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Detajimi i llogarisë 230 "Për aktivet afatgjata jo materiale" sipas objekteve paraqitet si me poshtë

Tabela nr. 41: *lekë*

"Për aktivet afatgjata materiale"	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Shërbim projekt zbatimi për hartimin e projektit Ndërtimi i rrugës se Lures (Arras Lure)	4,000,000			4,000,000
Shërbim projektim zbatimi për hartimin e projektit me objekt Ndërtimi I rrugës se Lurës	1,100,000			1,100,000
Shërbim projekt zbatimi për hartimin e projektit Ndërtimi I rrugës se Lurës (Arras Lure) situacion përfundimtar	3,876,000			3,876,000
Hartimi I projektit me objekt: Rikonstruksioni kryesor I furnizimit me ujë te qytetit te Peshkopisë nga burimet e Radomires	15,618,433			15,618,433
Hartimi i projektit me objekt Rikonstruksion kryesor i furnizimit me ujë te qytetit te Peshkopisë nga burimet e Radomires	3,929,566			3,929,566
Shërbim Projekt zbatimi I objektit Rikonstruksion I Rrugës kryesore ish-NBSH deri te ish-SMT	1,000,000			1,000,000
Shërbim projekt zbatimi I objektit .Rikonstruksion I Rrugës kryesore NBSH deri ish SMT	380,286			380,286
Shërbim Projekt zbatim sistemim asfaltimi I rrugës Peshkopi-Rabdisht	476,857			
Shërbim projekt zbatimi për rrugët e brendshme dhe rurale shkollave , kopshteve ne Bashkinë Dibër , financimi 2024	10,000,000	5,340,000	0	15,340,000
Totali	**40,381,142**	**5,340,000**	**0**	**45,721,142**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Llogaria 230 *"Aktive afatgjata jo materiale",* në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën prej 40,381,142 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën

45,721,142, duke pësuar një shtesë në vlerën 5,340,000 lekë "Shërbim projekt zbatimi për rrugët e brendshme dhe rurale shkollave , kopshteve në Bashkinë Dibër, financimi 2024"
Llogaria 231 "*AAGJM Investime në proces*", në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën prej 442,981,895 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 287,614,794 lekë . *Të detajuara në Aneks*

Pasivet (Detyrimet)

Llogaria e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Dibër me 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Tabela nr. 42: *lekë*

Llogaritë		Viti 2025	Viti 2024	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	85,519,433	60,489,611	25,029,822
42	Detyrime ndaj personelit	49,164,911	44,230,300	4,934,611
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	3,721,012	2,928,476	792,536
435	Sigurime shoqërore	14,619,045	13,125,519	1,493,526
436	Sigurime shëndetësore	2,022,516	1,810,029	212,487
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	63,494,361	59,042,571	4,451,790
467	Kreditorë të ndryshëm	128,424,391	165,433,833	-37,009,442
43,41	Operacione me shtetin (detyrime)	110,113,144	107,824,944	25,029,822
	Gjendja më fund të periudhës	**457,078,813**	**454,885,283**	**2,288,200**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Llogaria 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*", në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2024 në vlerën 60,489,611 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 në vlerën 85,519,433 lekë me diferencë për 25,029,822 lekë. Vlera 85,519,433 lekë përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj të tretëve, për fatura të pa likuiduara të fund vitit të cilat nuk kanë përmbushur afatin 60 ditorë për likuidim. *E detajuar në Aneks*

Gjendja llog.(42) "*Detyrime ndaj personelit*", gjendje në datë 31.12.2025 paraqitet në vlerë 52,795,454 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës. Ky detyrim është edhe për ndërmarrjet e varësisë të Bashkisë Dibër.

Tabela nr. 43: *lekë*

Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2025	44,230,300
Shtesa (K)	584,039,164
Pakësime (D)	579,104,553
Gjendja debitore në 31.12.2025	**49,164,911**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, konstatohet se:

Tabela nr. 44: *lekë*

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
1	08.01.2025	1,407,246
2	08.01.2025	245,709
3	08.01.2025	410,893
4	08.01.2025	244,130
5	08.01.2025	194,028
6	08.01.2025	480,908
7	08.01.2025	293,051
8	08.01.2025	147,077
9	08.01.2025	1,704,355
10	08.01.2025	1,923,983
11	08.01.2025	289,240
12	08.01.2025	8,967,111
13	08.01.2025	5,609,762

14	08.01.2025	1,353,613
15	08.01.2025	860,997
16	08.01.2025	43,026
17	08.01.2025	4,501,655
18	08.01.2025	2,419,583
19	09.01.2025	13,114,559
20	09.01.2025	19,374
	Totali	**44,230,300**

Burimi: Drejtoria Ekonomike

- Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa", paraqitet në vlerën lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Tabela nr. 45: *lekë*

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2025	2,928,476
Shtesa (K)	44,225,280
Pakësime (D)	43,432,744
Gjendja debitore në 31.12.2025	3,721,012

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025 konstatohet se:

Tabela nr. 46: *lekë*

Urdhër shpenzimi		
Nr.	Datë	Vlera
19	16.01.2025	2,928,476
Totali		2,928,476

Burimi: Drejtoria Ekonomike

- Llogaria 435 "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat lekë.

Tabela nr. 47: *lekë*

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	13,125,519
Shtesa (K)	174,338,428
Pakësime (D)	172,844,902
Gjendja debitore në 31.12.2025	14,619,045

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025 konstatohet se:

Tabela nr. 48: *lekë*

Urdhër shpenzimi		
Nr.	Datë	Vlera
19	16.01.2025	13,125,519
Totali		13,125,519

Burimi: Drejtoria Ekonomike

- Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat lekë.

Tabela nr. 49: *lekë*

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	1,810,029
Shtesa (K)	24,096,049
Pakësime (D)	23,883,561
Gjendja debitore në 31.12.2025	2,022,516

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025 konstatohet se:

Tabela nr. 50: *lekë*

Urdhër shpenzimi		
Nr.	Datë	Vlera
19	16.01.2025	1,810,029
Totali		1,810,029

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Gjendja llog.(466) "*Kreditorë për mjete në ruajtje*", gjendje në datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën 63,494,361 lekë e cila përfaqëson ngurtësimin si detyrime të Bashkisë ndaj operatorëve ekonomik për 5% garanci në punimet e objekte të ndryshme të përfshirë ndër vite. Gjatë periudhës raportuese ushtrimore viti 2025, Sektori financës ka dokumentuar ngurtësime si dhe likuidimet sipas tabelës në Aneks.
Llogaria 467 "*Kreditorë të ndryshëm*", paraqiten detyrimet për fatura të pa likuiduara dhe vendime gjykate të cilat për vitin 2025 paraqiten në vlerën 128,424,391 lekë, sipas pasqyrës *Aneks.*

-Llog. (4341) *"Operacione me shtetin (detyrime)"* në fund të periudhës raportuese ushtrimor viti 2025, paraqitet në vlerë 110,113,144 lekë e cila përfaqëson detyrimet debitorë të cilat i përkasin buxhetit të shtetit. Këto detyrime në aktivin e bilancit paraqiten në llog.(468) "Debitorë të ndryshëm" e cila është në vlerën 104,232,216 lekë e trajtuar në aktiv të pasqyrave të pozicionit financiar, si edhe në llog.(423) "Personeli, paradhënie, gjoba" në vlerën 5,880,928 lekë.
Analizë: Formati nr. 2 "Pasqyra e përformancës financiare" paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.
Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 2,111,034,075 lekë, paraqitet si më poshtë:
Gjendja e llogarisë sintetike*70* "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet" paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 50,502,428 lekë.
Gjendja e llogarisë sintetike*71* "Të ardhura jo tatimore" paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 88,353,656 lekë.
Gjendja e llogarisë sintetike*72* "Grante korrente" paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 1,972,177,991 lekë.
Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e llogarive të të ardhurave në Pasqyrën e performancës financiare, të pasqyruara në bilanc për vlerën 2,111,034,075 lekë, janë pasqyruar sipas Aktrakordimit dhe kodifikimit me Thesarin, gjë që vërteton plotësinë dhe vërtetësinë e vlerave të këtyre llogarive kontabël.
Analiza e shpenzimeve në vitin 2025 , të cilat në total janë në vlerën 1,967,404,215 lekë paraqitet më poshtë:
Gjendja e llogarisë *600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"* për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 699,908,174 lekë.
Gjendja e llogarisë *601 'Kontribute për sigurime"* për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 115,212,034 lekë.
Gjendja e llogarisë *602 "Blerje mallra e shërbime"* paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 160,577,815 lekë.
Gjendja e llogarisë së fondeve *604 "Transferime korente te brendshme"* paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 14,205,909 lekë.
Gjendja e llogarisë së fondeve *606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"* paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 979,901,277 lekë.
Për vitin 2025 totali i te ardhurave në vlerë është 2,111,034,075 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,967,404,215 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 143,629,860 lekë rakordon me gjendjen e llog. 85 "Rezultatin e ushtrimit"
Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës
Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. U krye verifikimi i likuidimeve të kontratave për mallra, shërbime e punime ndërtimi ku rezultoi se ato janë kryer brenda afateve të paraqitjes së faturës për të cilën Drejtoria e Financës ka plotësuar urdhër-shpenzime për likuidimin e tyre. Mallrat e blera gjatë vitit janë bërë hyrje në magazinë sipas kronologjisë së blerjeve dhe me kërkesë e urdhër dorëzimi janë bërë dalje nga magazina të firmosura nga përgjegjësi materiale.

Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit tarifave administrative vendore dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limit e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* pika 63 dhe 65 dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të Ligjit nr. 290, datë 14.06.1993 *"Për limitin e arkës"*. Për vitin 2025, nuk ka pagesa me arkë Të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në Bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje zero në fund të muajit. Gjithashtu është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël i cili rezulton i kuadruar.

Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet magazinës

Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga nen/Kryetari.

Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të Udhëzimit të MF nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Kuadri ligjor dhe nënligjor i verifikimit të zbatimit rekomandimeve

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, **bazuar në:**

I. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998", nenet 162-165 i ndryshuar.

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC

II. Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

-Neni 31 - **Raportimi në Kuvend ku parashikohet se:**

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit:
a) raport për zbatimin e Buxhetit të Shtetit;
b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi;
c) informacion për rezultatet e auditimeve sa herë që kërkohet nga Kuvendi;
ç) raporte përfundimtare të auditimit kur çmohet e nevojshme nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit apo kur kërkohen nga Kuvendi.
2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund t'i kërkojë Kuvendit, Komisionit për Ekonominë dhe Financat, apo ndonjë komisioni tjetër të Kuvendit, që të dëgjohet dhe të raportojë, për çështje që ai i çmon si të rëndësishme në funksion të veprimtarisë së tij.
3. Kontrolli i Lartë i Shtetit paraqet në Kuvend një raport vjetor mbi aktivitetet e tij brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

III. Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

-Neni 15, **Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së ku parashikohet se:** Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet:
a) të informojë drejtuesit e njësive të audituara apo institucioneve më të larta për shkeljet e akteve normative, me pasojë dëme materiale, dhe t'u rekomandojë atyre korrigjimin /rregullimin / ndryshimin e akteve ligjore;
b) të informojë drejtuesit e njësive të audituara apo organet e kompetencës mbi parregullsitë dhe dëmet financiare gjatë administrimit të fondeve publike dhe t'u rekomandojë atyre që çdo shumë e përdorur në shkelje të ligjeve apo akteve nënligjore të kompensohet dhe të dëmshpërblehet në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji;
c) t'u rekomandojë drejtuesve të njësive të audituara apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrative;
j) të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës;
k) t'u drejtohet organeve më të larta shtetërore të kompetencës në rast të moszbatimeve të rekomandimeve të dhëna nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit;

IV. Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

-Neni 30 -**Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, ku parashikohet se:** Në raportet e tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime në përputhje me nenin 15 të këtij ligji. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

V. Rregulloret e Brendshme të KLSH dhe udhëzimi i Kryetarit të KLSH për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH.

1. Rregullorja e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015;
2. Rregullorja e Brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit", miratuar me vendimin të kryetarit të KLSH -së nr. 107, datë 08.08.2017;

3. "Manual për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucional", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 67, datë 23.06.2020.

VI. <u>Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, për vlerësimin e veprimtarisë KLSH në vitin 2015</u>.
Në përmbushje të kërkesave të Rezolutës Kuvendit të Shqipërisë datë 20.10.2016 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015" ku në pikën 8, 11 dhe **<u>12 cilësohet</u>**: *"KLSH, në zbatim të kërkesave të ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit, duhet të rrisë adresimin e rekomandimeve në sektorë me impakt në publik, duke synuar që të jenë vlerë e shtuar në mirëqenien qytetare si dhe të kërkojë ndjekjen e zbatimit të tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe në këtë kontekst duke filluar nga viti i ardhshëm e në vijim, **<u>duhet të bëje pjesë integrale të raportit vjetor që paraqitet në Kuvend,</u>** edhe një raport që përfshin shkallën dhe mënyrën e zbatimit të rekomandimeve [...] si dhe analizën e shkallës së evadimit dhe zbatimit të rekomandimeve që kanë në përmbajtje të tyre masa zhdëmtimi".*

<u>1. Auditimi i fundit në Bashkinë Dibër</u>
Auditimi i fundit në Bashkinë Dibër është kryer në vitin 2025 për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 1084/21 prot., datë 02.12.2025. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:
- 44 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 4 masa të ardhura të munguara në vlerën 94,374,651 lekë;
- 2 masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën 101,618,041 lekë, pranuar nga subjekti;
- 13 masa disiplinore, pranuar nga subjekti.

<u>2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve</u>.
Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa j, Bashkia Dibër duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Dibër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 1084/21 prot., datë 02.12.2025 **nuk ka kthyer përgjigje** në KLSH.

<u>3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.</u>
Referuar shkresës nr. 1084/21 prot., datë 02.12.2025, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, pika 2, "*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*". Sipas verifikimit Bashkia Dibër **nuk ka kthyer përgjigje** në KLSH.

4. *<u>Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".</u>*
Nga verifikimi rezulton se Bashkia Dibër ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1084/21 prot., datë 02.12.2025, por **nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin

nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: *5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.*

5. Mbi nivelin e zbatimin të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Bashkinë Dibër
Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

Masa organizative Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Dibër 44 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkinë Dibër u konstatua se nuk është ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, nuk është hartuar regjistri i riskut, si dhe nuk janë hartuar aktivitetet e kontrollit për zvogëlimin e riskut të parashikuar, lista e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori. Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohet me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 8, pika 8, germa "b", neni 15, pikat 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 21, pika 2, neni 27, pikat 1-2, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2, pika 2.2.4, nënpikat 1-5, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II, pika 2.2.6, pika 2.5.2, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 21-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për hartimin e regjistrit të riskut të secilës strukturë dhe të gjithë institucionit, si dhe të hartohet gjurma e auditimit për veprimtaritë kryesore të institucionit.
Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.* **Koment i grupit të auditimit:** *Nga Bashkia Dibër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.* **Rekomandimi është i pazbatuar.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i organizimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në Bashkinë Dibër rezultoi se:
Prej muajit shkurt të vitit 2023 struktura është plotësuar me 3 (tre) anëtarë, të cilët përgjatë vitit 2023 kanë qenë të pa certifikuar, në kundërshtim me pikën 3 të VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar.
Një prej anëtarëve të NJAB-së është rekrutuar në kushtet e mos plotësimit të kritereve të posaçme, për të qenë anëtari i NJAB-së, pasi nuk zotëron diplomë universitare të nivelit të dytë, në kundërshtim me pikën 2 a të nenit 11 të Ligjit nr.114/2015 "*Për auditin e brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar, si dhe nuk ka pasur eksperiencën e nevojshme prej 3 vite, por vetëm 1 vit, në kundërshtim me pikën 2 ç , të nenit 11, të Ligjit nr.114/2015.

Drejtuesi i NJAB-së, nuk ka pasur pesë vite përvojë pune në momentin e emërimit si Drejtues i NJAB-së dhe nuk është certifikuar përgjatë vitit 2023, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2b, të nenit 11, të Ligjit nr. 114/2015.
Dy nga tre punonjësit e NJAB-së, për vitin 2023 kanë kryer trajnimet e vijueshme për 40 orë/vit, ndërsa një anëtar i NJAB-së, nuk ka realizuar asnjë orë trajnimi, në kundërshtim me nenin 5 të "Rregullores së trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik", të miratuar me Urdhrin nr. 3, datë 08.01.2016.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.114, datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 21-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa, që struktura e Njësisë së Auditit të Brendshëm të plotësohet me punonjës, të cilët përmbushin të gjitha kriteret e posaçme për punësimin si audituesi i brendshëm.
Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Për vitin 2025, punonjësit të cilët rezultonin të punësuar jo në përputhje me kriteret e posaçme për të qenë audituesi të brendshëm, janë në proces certifikimi.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procesit të planifikimit vjetor dhe strategjik të veprimtarisë së auditit të brendshëm u konstatuan se NJAB përpara procesit të planifikimit nuk ka plotësuar pyetësorët standard sipas përcaktimeve të Kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, i ndryshuar. Nga forma e paraqitjes së pasqyrës nr.3 "Plani vjetor i auditimit për vitin 2023" rezultoi një rresht tek kolona subjektet për t'u audituar, ku shënohet: "Kontrolle të ndryshme në çdo kohë", për të cilin planifikohet një auditim i kombinuar përputhshmërie dhe financiar, kjo e pabazuar në analizën e risqeve, si kusht paraprak për të qenë pjesë e planit vjetor. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Formatet Standard të Kapitullin nr. 3 të "Manualit i Auditimit të Brendshëm", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, i ndryshuar, "Identifikimi subjekteve", të kapitullit "*Formati Standard 5 të Manualit të AB. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 21-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1. Rekomandimi: Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për të realizuar një proces planifikimi të plotë, duke e dokumentuar këtë proces nëpërmjet plotësimit të të gjithë formularëve standard dhe në përzgjedhjen e subjekteve për auditim t'i kushtohet rëndësi e shtuar subjekteve të vlerësuara me "*risk të lartë*" të auditimit.
Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Referencat ligjore të vëna në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.*
Rekomandimi është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të buxhetit u konstatua se për vitin 2023, ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për shpenzime operative të cilat nga 223,879 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 156,950 mijë lekë dhe shpenzimeve për investime të cilat nga 599,593 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 437,695 mijë lekë. Për vitin 2024, për shpenzime operative të cilat të planifikuara në fillim të vitit janë për vlerën 207,290 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 76,701 mijë lekë ose 85% me mosrealizim në vlerën 30,589 mijë lekë dhe shpenzimeve për investime të cilat nga 427,178 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 322,549 mijë lekë ose 75%, me mosrealizim për vlerën 104,629 mijë lekë, të cilat janë zërat më kryesor të buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në funksionimin dhe ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar dhe Ligjit nr. 68-2017, "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", i ndryshuar neni 5, germa "a dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 35-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxheteve paraardhëse me qëllimin që programimet e shpenzimeve buxhetore, të jenë sa më të argumentuar. Shpërndarja e fondeve buxhetore, planifikimi i realizimit të procedurave të prokurimit të bëhet mbi baza reale bazuar në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, me qëllim përdorimin me efiçencë të burimeve financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, por në disa raste janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:*

-Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.12. Hapi 11, "Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar".

- Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese", në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

-Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si Projekt Raportet edhe Raportet Përfundimtare të Auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual. Në dosje janë të administruara komentet në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të raportuara nga Bashkia Dibër në Ministrinë e Financave u konstatua se, për faturat e palikuiduara dhe vendimeve gjyqësore të raportuara, në fund të vitit 2023 janë për vlerën 148,958,096 lekë dhe në fund të vitit 2024 janë për vlerën 113,972,447 lekë pra me ulje për vlerën 34,985,649 lekë. Nga verifikimi i faturave të palikuiduara kryesisht për investime u konstatua se nuk është ndjekur radha e pagesës, pasi janë likuiduar fatura të vitit 2023/2024, duke lënë papaguar fatura të vitit 2022, në 43 raste për vlerën 46,771,725 lekë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 40,42. Udhëzimin i MFE nr. 9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Kreu "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 35-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomik, Bashkia Dibër të marrë masa për të paraqitur në mbledhjen e Këshillit Bashkiak një material të detajuar mbi gjendjen aktuale të faturave të palikuiduara, në vlerën prej 113,972,447 lekë. Gjithashtu, të hartojë një plan për likuidimin e këtyre detyrimeve, duke respektuar rendin kronologjik të pagesave, me përparësi për detyrimet e krijuara përpara vitit buxhetor, me qellim shmangien e kostove shtesë për buxhetin, të shkaktuara nga vonesat në pagesa.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Ne fund te vitit 2025 gjendja e detyrimeve është ne vlerën 128,424,391 nga te cilat kemi gjendjen nga viti 2024 ne vlerën 164,427,038, shtesat e detyrimeve per vitin 2025 janë ne vlerën 199,953,355 dhe likuidimet gjate vitit 2025 te detyrimeve janë ne vlerën 235,956,022. Nga këto fatura te likuiduara gjate vitit 2025, ne zbatim te rekomandimit te KLSH per vitin 2025, janë likuiduar fatura nga viti 2024 ne vlerën 125,653,416 dhe faturat e likuiduara te vitit 2025 janë ne vlerën 110,302,586.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

6. Gjetje nga auditimi: Referuar evidencës së realizimit të të ardhurave, Taksa mbi tokën e cila për vitin 2023 nga 5,300 mijë lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 889 mijë lekë ose 17%, dhe për vitin 2024 nga 5,300 mijë lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 1,309 mijë lekë ose 25%. Nga regjistrat që disponohen pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, pranë bashkisë Dibër, sipërfaqja gjithsej është 19117 ha, nga kjo tokë në pronësi private 12686 ha dhe tokë në pronësi shtetërore 6421 ha. Nga evidenca e cila ka dhe kategoritë përkatëse për cilësinë e tokës bujqësore e shpërndarë me bazë fshati, fondi i tokës Bujqësore gjithsej 18958 ha, dhe 11792 ha në pronësi me AMTP apo certifikata pronësie. Kategoria e V 1491 ha, kategoria VI 1956 ha, kategoria e VII 4082 ha, kategoria e VIII 2582 ha, kategoria e IX 1454 ha dhe kategoria e X 227 Ha. Referuar këtyre të dhënave, plani duhej të ishte në vlerën 17,250,520 lekë, ndërkohë plani i vendosur është 5,300,000 lekë, me një diferencë në vlerën 11,950,520 lekë, si në vitin 2023 dhe vitin 2024 (17,250,520 - 5,300,000), gjë e cila ka sjell të ardhura të planifikuara më pak për buxhetin e bashkisë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin taksave vendore" i ndryshuar neni 23, pika 1,

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Bashkia Dibër, të evidentojnë dhe planifikojnë saktë taksën e tokës bujqësore, referuar kategorisë së tokës dhe ndarjes për familje, kjo për eliminuar mungesën e të ardhurave në planifikim e saj.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Për vitin 2024 niveli i Borxhit për 4 mujorin e dytë 2024 është në ulje në krahasim me 12-mujorin 2023 dhe 4-mujorin e parë 2024.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e ujitjes dhe kullimit referuar evidencave të paraqitura nga Drejtoria e Bujqësisë, Bashkia Dibër për vitin 2023 dhe 2024, u konstatua se sipërfaqja e projektuar për vaditje është 4145 ha, ndërsa në fakt si për vitin 2023 dhe 2024 sipërfaqja faktike e vaditur është 2836 ha për sasinë e ujët të përdorur 17902 m^3. Sipas informacionit të marrë nga DATTV mbi arkëtimet e kësaj tarife, u konstatua se për vitin 2023 është arkëtuar vlera 186,523 lekë dhe për vitin 2024 është arkëtuar vlera 121,695 lekë. Sa më sipër nuk u paraqit dokumentacion për sasinë e ujit që vihej në dispozicion nga Drejtoria e Bujqësisë, për çdo Njësi administrative për sipërfaqen e tokës që duhej vaditur në bazë të një aktrakordimi midis personave përgjegjës, si dhe nuk është i dokumentuar vlera e arkëtimeve që bëhej nga personi i caktuar nga administratori e pagesave që kryenin qytetarët. Pagesat e qytetarëve janë derdhur në bankë nga NJA sipas një fature për arkëtim të lëshuar nga DATTV me përshkrimin *"Tarifë Vaditje"*, por mungon "Gjurma e auditimit", e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, që përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar neni 12, pika 3, germa "dh" dhe "f", Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar, pikat 61-72.
7.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dibër në bashkëpunim me Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të auditojë në Drejtorinë e Bujqësisë Bashkia Dibër, Drejtorinë e të Ardhurave të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe njësitë administrative, mbi menaxhimin e tarifës së ujitjes për periudhën 2023-2024, si dhe të kryhen rakordimet ndërmjet strukturave për të ardhurat e vjela nga shërbimi i ujitjes.
Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Për vitin 2024 niveli i Borxhit për 4 mujorin e dytë 2024 është në ulje në krahasim me 12-mujorin 2023 dhe 4-mujorin e parë 2024.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi pasqyrave financiare rezultoi se llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*", në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 101,944,016 lekë. Nga verifikimi analitik i kësaj llogarie rezultoi se në këtë shumë nuk janë përfshirë detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë që rrjedhin nga lejet e legalizimeve, në vlerën 3,461,140 lekë, si dhe debitorë familjarë në shumën 53,139,417 lekë, gjithsej në vlerën 56,600,557 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu III. pika 30.
8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Dibër, të marrë masa për të kontabilizuar vlerën prej 56,600,557 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit dhe debitorët familjarë për taksa e tarifa vendore, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative

dhe ligjore për arkëtimin e tyre.
Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.* **Koment i grupit të auditimit:** *Me gjithë përpjekjen e Drejtorisë së Taksave Vendore, akoma evidentohet fakti se puna e kësaj administrative nuk është në nivelet që kërkohen, pasi dhe për vitin 2024 plani i të ardhurave nuk është realizuar sipas parashikimit, por është realizuar në masën 75%.* **Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.**

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se gjendja e llogarisë *4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"*, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 122,583,935 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës 4 të Pasivit për paga, sigurime, tatime dhe furnitorë të ndryshëm, vlerë e cila nuk kuadron me Llogarinë 7206 "*Financim i pritshëm nga buxheti*" të Pasqyrës së Performancës Financiare, e cila paraqitet në vlerën 0 lekë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III. pika 32 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Dibër, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerave të llogarive sipas pozicioneve, për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.
Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2025

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.* **Koment i grupit të auditimit:** *Ne fund te vitit 2025,gjendja e llogarisë 4342 'Te tjera operacione me shtetin (te drejta)' e paraqitur ne vlerën 155,046,917 leke, e cila përfaqëson llogarite e klasës 4 te Pasivit për paga, sigurime, tatime dhe furnitorë te ndryshëm,* ***kuadron*** *me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" te Pasqyrës se Performances Financiare, si rezultat i sistemimeve te kryera dhe regjistrimeve kontabël përkatëse duke siguruar rakordimin dhe pasqyrimin e sakte te llogarisë cituar për sa me sipër, ne përputhje me dokumentacionin justifikues dhe kërkesat e kuadrit ligjor e rregullator për kontabilitetin publik.* **Rekomandimi është i zbatuar pjesërisht.**

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 202 *"Studime dhe projektime*", sipas Formatit nr. 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata jo materialë (kosto historike)"*paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 65,256,270 lekë (viti 2023: 66,333,870 lekë). Nga verifikimi i inventarit kontabël rezultoi se vlera prej 55,313,000 lekë që i përket studimeve e kërkimeve të cilat janë pjesë e këtij inventari, nuk ka informacion nëse janë vënë në zbatim ose jo pavarësisht faktit që disa nga këto studime e kërkime i përkasin investimeve për objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim, të cilat duheshin sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, kjo ka sjellë paraqitjen e AAGJM më pak për këtë vlerë, për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk e pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e AAGJM, të numrit të tyre për efekt të inventarizimit fizik dhe llogaritjes së amortizimit, veprim në mospërputhje me Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, i ndryshuar dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së

punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika "c", nën pika "b". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Dibër, të kryejë analizë të detajuar të dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për projektet e hyra në vite nga ish-Njësitë Vendore, që i janë bashkuar nga reforma territoriale, me qellim verifikimin, saktësimin dhe analizimin e vlerës prej 55,313,000 lekë, të paraqitura në pasqyrat financiare, si dhe të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Për projektet e vëna në zbatim, të bëhet sistemimet përkatëse, duke debituar llogaritë e aktiveve dhe kredituar llogarinë *202 "Studime projektime".*

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike është koordinuar me strukturat përgjegjëse te bashkisë, në veçanti me Zyrën e Urbanistikes, e cila po ndjek procedurat teknike dhe administrative për identifikimin, verifikimin dhe rivlerësimin e aktiveve.*

Aktualisht procesi është ne fazën e evidentimit dhe përgatitjes se dokumentacionit përkatës, sipas kërkesave ligjore dhe standardeve te kontabilitetit publik. Pas përfundimit te procedurave te rivlerësimit dhe miratimit te dokumentacionit teknik, Drejtoria Ekonomike do te kryeje analizën e dokumentacionit financiar e ligjor, gjithashtu edhe regjistrimin kontabël dhe sistemimin përkatës, duke reflektuar vlerën reale te aktiveve ne llogarinë 202" "Studime dhe projektime".

Rekomandimi është në proces zbatimi.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 210 *"Toka troje terrene*", sipas Formatit nr. 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata jo materialë (kosto historike)",* paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 e vitit 2024 në vlerën 28,394,404 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie u konstatua se, nuk është pasqyruar vlera e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të shkollave, kopshteve, konvikteve, godina e Bashkisë dhe ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë nëpërmjet Strukturave Përgjegjëse të Bashkisë Dibër, të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në funksion të përditësimit të inventarit, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të konvikteve, godina e Bashkisë, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, përmes verifikimit juridik dhe faktik të trojeve nën objekt dhe të truallit funksional, për regjistrimin, vlerësimin e tyre dhe pasqyrimit në kontabilitet.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga ana e Bashkisë Dibër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi*

Rekomandimi është i pa zbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" dhe 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", referuar analizës së inventarit kontabël u konstatua se, vlerat

investimeve për rikonstruksione, mbikëqyrje dhe kolaudimin e objekteve nuk i janë bashkuar vlerës së objekteve, si kosto shtesë e vlerës fillestare të AAGJM. Gjithashtu në llogarinë 212 "*Ndërtesa Konstruksione*" dhe 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore***"** pasqyrohen vlera të paanlizuara me objekte, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Dibër, bazuar në dokumentet financiare e ligjore të saktësojë aktivet e hyra në vite për të verifikuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare, si dhe të bëjë sistemimet përkatëse për investimet e kryera gjatë periudhave, në llogaritë 212 "*Ndërtesa Konstruksione*" dhe llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete vepra ujore*".

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2025

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga ana e Bashkisë Dibër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pa zbatuar.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlerave të aktiveve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, u konstatua se nuk paraqesin "vlerën reale" të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Dibër, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes, si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarit të llogarisë 212 "*Ndërtesa dhe konstruksione*" për 11 objekte variojnë nga 25,000 lekë deri në 99,000 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, pika 105. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1.Rekomandimi: Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike të marrë masa për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 "*Aktive afatgjata materiale*" dhe llogarisë 109 "*Diferenca nga rivlerësimi*".

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga ana e Bashkisë Dibër, nga Drejtoria Ekonomike është kryer sistemimi dhe riorganizimi i evidencave analitike të aktiveve afatgjata materiale, duke përmirësuar identifikimin, klasifikimin dhe pasqyrimin e tyre në regjistrat kontabël. Gjithashtu janë kryer verifikime dhe rakordime të të dhënave kontabël me dokumentacionin administrativ përkatës. Ky proces ka shërbyer si bazë për evidentimin e saktë të aktiveve dhe përgatitjen e tyre për procedurat e mëtejshme të rivlerësimit. Megjithatë, procesi i rivlerësimit të aktiveve nga ekspertë të licencuar nuk është përfunduar ende, për rrjedhojë vlerat e aktiveve vazhdojnë të paraqiten me kosto historike në pasqyrat financiare. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht. Drejtoria Ekonomike do të vijojë*

me ndërmarrjen e procedurave ligjore për kryerjen e rivlerësimit të aktiveve dhe pasqyrimin e diferencave përkatëse në kontabilitet, në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe udhëzimeve në fuqi.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se në llogarinë 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, nuk është zbritur vlera prej 1,821,675,198 lekë, për 86 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve, që sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" duhej transferuar në Ujësjellës Kanalizime Dibër, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85**,** Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022,Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
14.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë e PZHKT Bashkia Dibër, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për transferimin në shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" ShA të 86 artikujve kontabël pjesë e inventarit, me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në pasqyrat financiare, duke zbritur vlerën 1,821,675,198 lekë.
Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2025

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Për evidentimin dhe verifikimin e 86 artikujve të rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve të përfshirë në inventarin kontabël të llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore". Në bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë Ekonomike dhe strukturave përgjegjëse është kryer rishikimi i evidencave kontabël dhe fizike, si dhe sistemimi i të dhënave analitike për aktivet që sipas legjislacionit në fuqi duhet të transferohen në shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" ShA.*
Janë identifikuar aktivet objekt transferimi dhe është përgatitur dokumentacioni mbështetës për vijimin e procedurave administrative dhe ligjore të dorëzimit Me konkretisht VKB Nr.38 dt 03/09/2025.
Për shkak se procedura e transferimit është ne proces dhe nuk ka përfunduar ende plotësisht, vlera prej 1,821,675,198 lekë vazhdon të figurojë në pasqyrat financiare të Bashkisë. Pas finalizimit të procesit do të kryhen veprimet kontabël për zbritjen e kësaj vlere nga llogaria përkatëse dhe reflektimin e ndryshimeve në pasqyrat financiare.
Rekomandimi është në proces zbatimi.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga bashkia është kryer inventarë fizik për llogarinë 31 "Materiale", llogarinë 32 "Inventarë i imët", llogarinë 214 " Instalime teknike Makineri pajisje" llogarinë 215 "Mjete transporti", llogarinë 214 " Instalime teknike Makineri pajisje" dhe llogarinë 218 "Inventarë ekonomik", ndërsa për llogaritë e tjera të Aktiveve Afatgjata Materiale nuk është kryer inventarë fizik si rrjedhojë pasqyrat financiare përmbajnë vetëm vlerat kontabël të tyre, duke krijuar pasiguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket llogarive në fund të vitit,. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat; 74, 77,

83, 85/a, b, 86, 95, UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar Kreu III, pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike, të marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve, si: llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje Plantacione", 212 "Ndërtesa e Konstruksione", 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", duke bërë dhe verifikimin në terren të tyre. Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse për sistemimin e llogarive kontabël.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2025

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga ana e Bashkisë Dibër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë kontabël 24 "Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara", sipas Formatit nr.7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", ku në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën prej 27,776,781 lekë, u konstatua se nga Bashkinë Dibër nuk është ngritur komision për asgjësimin dhe vlerësimin si skrap, me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave. Kjo shumë përbëhet nga pajisje kompjuterike në vlerën 4,302,583 lekë, të cilat i përkasin llogarisë 218 "Inventarë ekonomik" dhe 16 automjeteve të dëmtuara në vlerën 23,474,198 lekë, të cilat i përkasin llogarisë 215 "Mjete transporti". Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 , 85, 109, 110 dhe 111. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Dibër, të marrë masa që për "Aktivet afatgjata materiale", të vlerësuara të dëmtuara në vlerën 27,776,781 lekë, të bëjë grupimin duke caktuar një person përgjegjës, si dhe të ngrejë komision për asgjësimin dhe vlerësimin e tyre për skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga ana e Bashkisë Dibër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 17.1, 18.1, 19.1, 20.1, 21.1, 22.1, 23.1, 24.1, 25.1, 26.1, 27.1, 28.1, 29.1, 30.1, 31.1, 32.1, 33.1, 34.1, 35.1, 36.1, 37.1, 38.1, 39.1, 40.1, 41.1 dhe 42.1, zbatimi i tyre do të shqyrtohet në Auditimin e ardhshëm pasi janë pjesë e auditimit të përputhshmërisë dhe në bazë të Programit të Auditimit nr. 551/1, datë 22.05.2026 janë audituar vetëm rekomandimet e lëna për;

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik
- Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm
- Auditimin mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit
- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.
- Auditim i llogarive vjetore

Në lidhje me rekomandimet për pikat të cilat nuk janë objekt auditimi, zbatimi i këtyre Rekomandimeve do të jetë subjekt i auditimit të radhës.
Pikat të cilat nuk janë objekt auditimi janë;
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.
- Auditim mbi zbatimin e kontratave punime ndërtimi.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Planifikimit, Kontroll dhe Zhvillim Territorit.
- Auditimit mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit (IMT)
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

Nga verifikimi i dokumentacionit, në lidhje me *zbatimin e rekomandimeve të ri kërkuara* konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- ✓ Nga **13 masa organizative** të rekomanduara, pranuar 100% nga subjekti. Nga këto është **zbatuar 1 masë**, janë **në proces 12 masa**.
- ✓ Nga **5 masa për uljen e borxhit tatimor,** pranuar 100% nga subjekti, **rezultojnë 5 në proces.**
- ✓ **Nga 1 masë për eliminimin e efekteve negative,** pranuar 100% nga subjekti, **rezultojnë 1 në proces.**

MASA ORGANIZATIVE

4.1. Rekomandimi: *Drejtuesi i Njësisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa, që në bashkëpunim më anëtarët e tjerë të NJAB-së të realizojnë dokumentimin e punës audituese dhe të bëjë një shpërndarje të punës audituese, që të shmangen mbivendosjet e auditimeve në terren në të njëjtën kohë.*

7.1. Rekomandimi: *Bashkia Dibër të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 501,102 mijë lekë, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.*

8.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër të angazhohet në marrjen e masave për një planifikim sa më të saktë duke bashkëpunuar me struktura të bashkisë.*

9.1. Rekomandimi: *Nga Bashkia Dibër, të merren masa në mënyrë të menjëhershme që të bllokohet aktiviteti ekonomik i këtyre guroreve (sipas tabelës II.6.9), deri në momentin e përfundimit të procedurave ligjore, në lidhje me heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve përkatëse të guroreve të sipërcituara. Gjithashtu, para momentit të zhbllokimit, pasi të jenë kryer të gjitha procedurat ligjore për heqjen nga fondi pyjor, Bashkia Dibër të bëjë një vlerësim për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm i sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor, dhe t'jua faturojë subjekteve përkatëse private me aktivitet gurore.*

10.1. Rekomandimi: *Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore dhe të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për të regjistruar dhe pajisur me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim sipas ligjit.*

11.1. Rekomandimi: *Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për menaxhimin e aseteve të veta të kullotave, për të rritur të ardhurat sipas planifikimit në paketën fiskale të vitit 2022, në kapitullin dhe 2.8.2 dhe 2.8.3 "Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimore" e kontratave.*

13.1 Rekomandimi: *Titullari i Bashkisë Dibër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin zë për zë të llogarive analitike të llogarisë nr.202 "Studime dhe Kërkime", me qëllim përcaktimin e destinacionit të tyre për të mundësuar statusin e secilit zë dhe më pas nga*

Drejtori Ekonomik të kryhen regjistrimet kontabël në lidhje me kapitalizimet në aktivet përkatëse apo çregjistrimet sipas rastit.

17.1 Rekomandimi: *Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për menaxhimin dhe kontrollin e kontratave të cilave ju ka mbaruar afati i parashikuar në kontratë, të njoftojë kontraktuesit për kushtet e lidhura në kontratë në të kundërt të njoftojë për prishje të saj.*

18.1 Rekomandimi: *Bashkia Dibër dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve, të marrin masa dhe të ndjekin të gjitha procedurat ligjore për ruajtjen, identifikimin e dëmtuesve dhe menaxhimin e kontrollin e pyjeve, duke mos funksionojë vetëm si drejtori evidentuese, por te menaxhojë asetet sipas ligjit te inspektimit ne Republikën e Shqipërisë.*

20.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të shmangë angazhimet për procedura prokurimi pa fonde në dispozicion, kjo për të shmangur rritjen e borxhit të bashkisë.*

23.1. Rekomandimi: *Nga Bashkia Dibër, të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore.*

24.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Dibër, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, kjo jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit. Të synohet që stafi i kualifikuar të jetë me drejtim inxhinierie.*

- IMT Bashkia Dibër, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

- IMT Bashkia Dibër, të aplikojë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave në përputhje me natyrën e shkeljes. Të merren masa për ekzekutimin e vendimeve për prishje, dhe në rast mungese të mjeteve, Kryetari i Bashkisë të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje. Të përgatiten planet mujore/vjetore të punës nga K/inspektori.

MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Taksave, të marrin masa për nxjerrjen e njoftim detyrimit ndaj subjekteve zhvillues A A, L S, I S, M S dhe V M, për të bërë të mundur arkëtimin e shumës* ***5,735,388 lekë*** *si rezultat i përllogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga të cilat për shtetasin A A vlera* ***5,527,524 lekë****, për shtetasen L S vlera* ***74,470 lekë****, për shtetasin I S vlera* ***78,277 lekë****, për shtetasen M. S. vlera* ***32,835 lekë****, për shtetasin V M vlera* ***22,282 lekë****, shuma të cilat përbëjnë të ardhura të paarkëtuara për buxhetin e Bashkisë Dibër.*

2.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë me Drejtorinë e të ardhurave dhe struktura të tjera të bashkisë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 12,598,557 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e Bashkisë Dibër të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

3.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022.ë vlerën: -Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 47,713,042 lekë;*
-Biznese Debitorë në vlerë 11,403,160 lekë.
a- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
e- Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Dibër, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.
4.1. Rekomandimi: *Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale* ***1,230,000 lekë për vitin 2022****. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.*
6.1. Rekomandimi: *Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore deri në procese gjyqësore për të likuiduar detyrimin e pa likuiduar te prapambetur prej dy vitesh në vlerën* ***8,494,504 lekë****.*

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë vlerësimet e gabuara të kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për personat përgjegjës për shpenzimet pa ekonomicitet në vlerën* ***8,291 mijë lekë****.*

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkinë Dibër u konstatua se sistemi nuk është ngritur dhe dokumentuar në mënyrë të plotë dhe efektive. Konkretisht, u konstatua se në periudhën objekt auditimi, nuk është hartuar regjistri i riskut dhe aktivitetet e kontrollit për adresimin e risqeve, ndërsa nga strukturat përkatëse nuk janë dokumentuar lista e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit. Gjithashtu, në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës, nuk janë përcaktuar dhe dokumentuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre.

Këto mangësi janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, veçanërisht nenet 8, 11, 12, 16 dhe 21, dhe në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010. Manuali i MFK-së e përfshin këtë kuadër si bazë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1., faqe 17-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Dibër, në bashkëpunim me koordinatorin e MFK-së dhe strukturat përgjegjëse, të marrë masa për plotësimin dhe funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke hartuar dhe përditësuar regjistrin e riskut, përcaktuar aktivitetet e kontrollit për adresimin e risqeve, dokumentuar proceset e punës dhe gjurmët e auditimit, si dhe duke përcaktuar dhe dokumentuar kriteret e përzgjedhjes së punonjësve sipas kërkesave të pozicioneve përkatëse, me qëllim garantimin e transparencës, objektivitetit, gjurmueshmërisë dhe efektivitetit të proceseve administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i organizimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në Bashkinë Dibër rezultoi se:

-Për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Dibër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Sektori i Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit;

-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;

-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;

- NjAB në Bashkinë Dibër nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 *"Dosja e Përhershme". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2, faqe 27-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Njësiqa e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Dibër, të marrë masa për:

- Shqyrtimin e risqeve më të rëndësishëm për planifikimin dhe zbatimin e projekteve, programeve në të cilat janë fokusuar objektivat strategjikë, të njësisë publike,
- Respektimin, nga audituesit e brendshëm, të strukturës së përcaktuar për raportet e auditimit dhe plotësimin e opinionit të përgjithshëm lidhur me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në raportet e hartuara në përfundim të çdo angazhimi auditimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të buxhetit për vitin 2025 rezultoi se, ndonëse në total shpenzimet janë realizuar në masën 91.5% të planit të miratuar, janë konstatuar diferenca të konsiderueshme ndërmjet planifikimit dhe realizimit për disa kategori shpenzimesh. Konkretisht, nga fondi i planifikuar prej 2,561,354,567 lekë janë realizuar 2,343,818,470 lekë, duke mbetur të parealizuara 217,536,097 lekë.Niveli më i ulët i realizimit u konstatua në shpenzimet kapitale (investimet), ku nga 388,510,755 lekë të planifikuara janë

realizuar 265,258,531 lekë ose 68.3%, me një diferencë prej 123,252,224 lekë. Në këtë nivel realizimi ka ndikuar mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara, duke evidentuar se planifikimi i shpenzimeve, veçanërisht i investimeve, nuk është mbështetur plotësisht në kapacitetet reale të Bashkisë Dibër për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Gjithashtu, gjatë zbatimit të buxhetit nuk janë përshtatur në mënyrë të mjaftueshme shpenzimet e planifikuara me nivelin faktik të të ardhurave të realizuara.. Kjo situatë është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar**,** me nenin 44**,** 45 dhe 46. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 32-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Drejtorive përgjegjëse për investimet, të marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit buxhetor, duke bazuar parashikimet e shpenzimeve kapitale në analiza reale të burimeve financiare të disponueshme, nivelit të financimit dhe kapaciteteve për zbatimin e projekteve, me qëllim shmangien e planifikimeve të parealizueshme dhe rritjen e nivelit të realizimit të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Dibër, në datën 01.01.2025, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive, me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti, në vlerën 163,327,672 lekë. Gjatë periudhës 01.01.2025–31.12.2025 janë krijuar detyrime në vlerën 201,052,721 lekë, ndërsa shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2025 rezulton në vlerën 235,956,002 lekë. Në datën 31.12.2025, detyrimet e mbetura, të raportuara nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, rezultojnë në vlerën 128,424,391 lekë. Pesha specifike e stokut të detyrimeve ndaj fondeve faktike rezulton 8.34%. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë auditimit rezultoi se detyrimet e mbetura në fund të periudhës përfshijnë fatura të cilat, në datën e auditimit, kanë tejkaluar afatin 60-ditor të likuidimit. Kjo situatë evidenton praninë e detyrimeve të pashlyera brenda afateve të përcaktuara, të lindura nga marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*", i ndryshuar**,** dhe Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*"**;** neni 52 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 32-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria e Financës të marrin masa që, me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, të parashikojnë shlyerjen e detyrimeve të papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, duke sjellë zvogëlim të fondeve për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve dhe dokumentacionit justifikues të pagesave për periudhën objekt auditimi, u verifikua respektimi i afateve ligjore për likuidimin e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomikë. Nga testimet e kryera rezultoi se 263 fatura janë likuiduar pas tejkalimit të afatit ligjor të pagesës**,** duke evidentuar mosrespektim të kërkesave të legjislacionit në fuqi për pagesat e detyrimeve kontraktore dhe tregtare, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*", i ndryshuar**,** dhe Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*"**;** neni 52 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 32-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar dhe monitorimin e vazhdueshëm të detyrimeve ndaj operatorëve ekonomikë, me qëllim respektimin e afatit ligjor 30-ditor për paraqitjen dhe ekzekutimin e pagesave, duke shmangur krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe duke garantuar zbatimin e kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura. Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **300,000,000 lekë** dhe realizimi në vlerën **205,011,111 lekë** ose në masën 68% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **94,988,889 lekë**.
Nga Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II, pika 2, germa "a" dhe "b", Kreu III, pika 32.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 39-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1. Rekomandimi: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër të marrë masa që në hartimin e planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2025 ndërmjet Drejtorisë së Tatim Taksave, Bashkia Dibër dhe agjentëve tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimeve, Dibër, ASHK Dibër, DSHTRR Dibër dhe Ujësjellës Kanalizime Sh.A, Dibër) nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore me përjashtim të agjentit tatimor "Ujësjellës Kanalizime Sh.A", me të cilin janë bërë çdo muaj rakordime.
Për sa i përket arkëtimeve të realizuara nga agjentët tatimore, Bashkia Dibër i referohet vetëm vlerave të arkëtuara nga agjentët tatimorë sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit, por nuk ka asnjë bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimorë dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre, veprime këto në kundërshtim me Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore", neni 117, "Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët", pika b), Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, "Për taksat kombëtare*".*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 39-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dibër, të marrë masa për kryerjen e rakordimeve mujore me të gjithë agjentët tatimorë, për të patur një pasqyrë më të qartë mbi detyrimet e arkëtuarara si dhe detyrimet e pambledhura.

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dibër, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi pasqyrave financiare rezultoi se llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 104,944,016 lekë. Nga verifikimi analitik i kësaj llogarie rezultoi se në këtë shumë nuk janë përfshirë detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë që rrjedhin nga lejet e legalizimeve, në vlerën 4,360,122 lekë, si dhe debitorë familjarë në shumën 57,473,417 lekë që rezulton një total prej 61,833,539 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu III. pika 30.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Dibër, të marrë masa për të kontabilizuar vlerën prej 61,833,539 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit dhe debitorët familjarë për taksa e tarifa vendore, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 210 *"Toka troje terrene*", sipas Formatit nr. 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata jo materialë (kosto historike)",* paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 28,394,404 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie u konstatua se, nuk është pasqyruar vlera e truallit nënobjekt dhe të truallit funksional, të shkollave, kopshteve, konvikteve, godina e Bashkisë dhe ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
9.1. Rekomandimi:
Kryetari i Bashkisë Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse për administrimin e pronave, të marrë masa për identifikimin, evidentimin dhe dokumentimin e trojeve nën objekt dhe trojeve funksionale të shkollave, kopshteve, konvikteve, godinës së Bashkisë dhe ndërtesave që ndodhen në Njësitë Administrative, si dhe për përcaktimin e vlerës së tyre, sipas dokumentacionit ligjor dhe financiar përkatës. Pas përfundimit të këtij procesi, të kryhet regjistrimi dhe pasqyrimi i plotë i vlerave përkatëse në llogarinë 210 "Toka, troje, terrene", si dhe rakordimi i tyre me inventarin fizik, me qëllim sigurimin e saktësisë së informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" dhe 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", referuar analizës së inventarit kontabël u konstatua se, gjatë viteve vlerat e investimeve për rikonstruksione, mbikëqyrje dhe kolaudim të objekteve nuk i janë bashkuar vlerës së objekteve, si kosto shtesë e vlerës fillestare të AAGJM. Gjithashtu në llogarinë 212 "*Ndërtesa Konstruksione*" dhe 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" pasqyrohen vlera të paanlizuara me objekte. Gjithashtu është konstatuar se janë të pa analizuara me objekte vlera prej 135,940,644 lekë, për llogarinë 212 "*Ndërtesa Konstruksione*" dhe vlera prej 41,330,544 lekë për llogarinë 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*", veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Dibër, **të marrë masa** për analizimin dhe rakordimin e plotë të llogarive 212 dhe 213 sipas objekteve, duke identifikuar dhe dokumentuar përbërjen e vlerave të regjistruara në kontabilitet. Të evidentohen kostot e lidhura drejtpërdrejt me ndërtimin/rikonstruksionin e aktiveve, përfshirë shpenzimet e mbikëqyrjes dhe kolaudimit, dhe, pas verifikimit të dokumentacionit justifikues, të kryhen **sistemimet dhe korrigjimet kontabël përkatëse,** në mënyrë që vlera e AAGJM-ve në pasqyrat financiare të paraqitet e plotë, e saktë dhe e analizuar sipas objekteve.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë rezultoi se, gjatë procesit të inventarizimit fizik, është kryer verifikimi fizik për aktivet e regjistruara në llogaritë 31 "Materiale", 32 "Inventar i imët", 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje", 215 "Mjete transporti" dhe 218 "Inventar ekonomik".

Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacionit të inventarizimit rezultoi se nuk është kryer inventarizim fizik për aktivet e regjistruara në llogaritë e tjera të aktiveve afatgjata material.

Për rrjedhojë, për këto aktive, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare janë mbështetur vetëm në vlerat kontabël të regjistruara në evidencat financiare, pa u kryer verifikimi fizik dhe rakordimi i tyre me gjendjen faktike në fund të periudhës ushtrimore.

Mungesa e inventarizimit fizik të të gjitha aktiveve nuk siguron evidencë të mjaftueshme mbi ekzistencën, gjendjen, përdorimin dhe vlerën e aktiveve, si dhe nuk garanton rakordimin ndërmjet gjendjes fizike dhe evidencave kontabël. Për rrjedhojë, ekziston risk që në pasqyrat financiare të jenë paraqitur vlera për aktive të cilat nuk janë verifikuar fizikisht, duke krijuar pasiguri mbi saktësinë dhe plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat; 74, 77, 83, 85/a, b, 86, 95, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar Kreu III, pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit fizik të plotë të të gjitha aktiveve afatgjata materiale dhe të kryejë rakordimin e rezultateve të inventarizimit me evidencat kontabël.

Për diferencat që mund të rezultojnë nga procesi i inventarizimit, Bashkia të kryejë verifikimin, dokumentimin dhe sistemimet përkatëse në kontabilitet, në përputhje me kuadrin rregullator

në fuqi, me qëllim që aktivet e paraqitura në pasqyrat financiare të jenë reale, të plota, të sakta dhe të mbështetura me dokumentacion.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë kontabël 24 "Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara", sipas Formatit nr.7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", ku në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën prej 27,776,781 lekë, u konstatua se nuk është ngritur komision për asgjësimin dhe vlerësimin si skrap, me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave. Kjo shumë përbëhet nga pajisje kompjuterike në vlerën 4,302,583 lekë, të cilat i përkasin llogarisë 218 "Inventarë ekonomik" dhe 16 automjeteve të dëmtuara në vlerën 23,474,198 lekë, të cilat i përkasin llogarisë 215 "Mjete transporti". Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 , 85, 109, 110 dhe 111.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Dibër, të marrë masa që për "Aktivet afatgjata materiale", të vlerësuara të dëmtuara në vlerën 27,776,781 lekë, të bëjë grupimin duke caktuar një person përgjegjës, si dhe të ngrejë komision për asgjësimin dhe vlerësimin e tyre për skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 1084/21 prot., datë 02.12.2025, rezultoi se nga Bashkia Dibër nuk është kthyer përgjigje në plotësim të afatit 20 ditor dhe 6 muaj për zbatimin e rekomandimeve, veprime në kundërshtim me nenet 15 gërma j) dhe 30 pika 2 të Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa j).
Nga verifikimi i dokumentacionit, në lidhje me *zbatimin e rekomandimeve të ri kërkuara* konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:
- Nga **13 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100% të masave nga subjekti. Nga këto është **zbatuar 1 masë**, janë **në proces 12 masa**.
- Nga **5 masa për uljen e borxhit tatimor,** pranuar 100% nga subjekti, **rezultojnë 5 masa në proces.**
- Nga **1 masë për eliminimin e efekteve negative,** pranuar 100% nga subjekti, **rezultojnë 1 masë në proces.**
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 66-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
13. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

Menjëherë dhe në vijimësi

Masa organizative
4.1. Rekomandimi: *Drejtuesi i Njësisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa, që në bashkëpunim më anëtarët e tjerë të NJAB-së të realizojnë dokumentimin e punës audituese dhe të bëjë një shpërndarje të punës audituese, që të shmangen mbivendosjet e auditimeve në terren në të njëjtën kohë.*
7.1. Rekomandimi: *Bashkia Dibër të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 501,102 mijë lekë, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.*

8.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër të angazhohet në marrjen e masave për një planifikim sa më të saktë duke bashkëpunuar me struktura të bashkisë.*

9.1. Rekomandimi: *Nga Bashkia Dibër, të merren masa në mënyrë të menjëhershme që të bllokohet aktiviteti ekonomik i këtyre guroreve (sipas tabelës II.6.9), deri në momentin e përfundimit të procedurave ligjore, në lidhje me heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve përkatëse të guroreve të sipërcituara. Gjithashtu, para momentit të zhbllokimit, pasi të jenë kryer të gjitha procedurat ligjore për heqjen nga fondi pyjor, Bashkia Dibër të bëjë një vlerësim për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm i sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor, dhe t'jua faturojë subjekteve përkatëse private me aktivitet gurore.*

10.1. Rekomandimi: *Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore dhe të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për të regjistruar dhe pajisur me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim sipas ligjit.*

11.1. Rekomandimi: *Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për menaxhimin e aseteve të veta të kullotave, për të rritur të ardhurat sipas planifikimit në paketën fiskale të vitit 2022, në kapitullin dhe 2.8.2 dhe 2.8.3 "Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimtarinë" e kontratave.*

13.1 Rekomandimi: *Titullari i Bashkisë Dibër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin zë për zë të llogarive analitike të llogarisë nr.202 "Studime dhe Kërkime", me qëllim përcaktimin e destinacionit të tyre për të mundësuar statusin e secilit zë dhe më pas nga Drejtori Ekonomik të kryhen regjistrimet kontabël në lidhje me kapitalizimet në aktivet përkatëse apo çregjistrimet sipas rastit.*

17.1 Rekomandimi: *Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për menaxhimin dhe kontrollin e kontratave të cilave ju ka mbaruar afati i parashikuar në kontratë, të njoftojë kontraktuesit për kushtet e lidhura në kontratë në të kundërt të njoftojë për prishje të saj.*

18.1 Rekomandimi: *Bashkia Dibër dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve, të marrin masa dhe të ndjekin të gjitha procedurat ligjore për ruajtjen, identifikimin e dëmtuesve dhe menaxhimin e kontrollin e pyjeve, duke mos funksionojë vetëm si drejtori evidentuese, por te menaxhojë asetet sipas ligjit te inspektimit ne Republikën e Shqipërisë.*

20.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të shmangë angazhimet për procedura prokurimi pa fonde në dispozicion, kjo për të shmangur rritjen e borxhit të bashkisë.*

23.1. Rekomandimi: *Nga Bashkia Dibër, të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore.*

24.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Dibër, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, kjo jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit. Të synohet që stafi i kualifikuar të jetë me drejtim inxhinierie.*

- IMT Bashkia Dibër, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

- IMT Bashkia Dibër, të aplikojë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave në përputhje me natyrën e shkeljes. Të merren masa për ekzekutimin e vendimeve për

prishje, dhe në rast mungese të mjeteve, Kryetari i Bashkisë të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje. Të përgatiten planet mujore/vjetore të punës nga K/inspektori.

Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara.

1.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Taksave, të marrin masa për nxjerrjen e njoftim detyrimit ndaj subjekteve zhvillues A A, L S, I S, M S dhe V M, për të bërë të mundur arkëtimin e shumës* ***5,735,388 lekë*** *si rezultat i përllogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga të cilat për shtetasin A A vlera* ***5,527,524 lekë****, për shtetasen L S vlera* ***74,470 lekë****, për shtetasin I S vlera* ***78,277 lekë****, për shtetasen M S vlera* ***32,835 lekë****, për shtetasin V M vlera* ***22,282 lekë****, shuma të cilat përbëjnë të ardhura të paarkëtuara për buxhetin e Bashkisë Dibër.*

2.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë me Drejtorinë e të ardhurave dhe struktura të tjera të bashkisë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 12,598,557 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e Bashkisë Dibër të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

3.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022.ë vlerën: -Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 47,713,042 lekë;*

-Biznese Debitorë në vlerë 11,403,160 lekë.

a- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Dibër, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

4.1. Rekomandimi: *Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale* ***1,230,000 lekë për vitin 2022****. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.*

6.1. Rekomandimi: *Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore deri në procese gjyqësore për të likuiduar detyrimin e pa likuiduar te prapambetur prej dy vitesh në vlerën* ***8,494,504 lekë****.*

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

1.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë vlerësimet e gabuara të kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për personat përgjegjës për shpenzimet pa ekonomicitet në vlerën* ***8,291 mijë lekë****.*

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i likuidimeve të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore gjatë vitit 2025, rezultoi se Bashkia ka likuiduar detyrime në vlerën totale 1,942,095 lekë. Këto likuidime kanë të bëjnë me detyrime të lindura nga vendime gjyqësore, të cilat lidhen kryesisht me dëmshpërblime për punonjës të larguar nga puna, dëmshpërblime për pensione invaliditeti, si dhe vendime të tjera gjyqësore. Në mënyrë të veçantë, nga verifikimi i dokumentacionit financiar dhe urdhër-shpenzimeve përkatëse, rezultoi se gjatë vitit 2025 janë likuiduar detyrime në vlerën 1,232,773 lekë për dëmshpërblime page ndaj punonjësve të larguar nga puna, në zbatim të vendimeve gjyqësore. Këto pagesa përfaqësojnë detyrime të krijuara si rezultat i marrëdhënieve të punës dhe proceseve gjyqësore të zhvilluara për largimin nga puna.

Sa i përket detyrimeve që lidhen me dëmshpërblimet për pensione invaliditeti, nga auditimi dhe verifikimi i të dhënave të paraqitura në dokumentacionin financiar rezultoi se, në fund të periudhës së audituar, nuk kishte detyrime të papaguara për këtë kategori. Krijimi dhe mbartja e vazhdueshme e detyrimeve që burojnë nga vendime gjyqësore tregon se njësia nuk ka arritur të minimizojë kostot financiare që rrjedhin nga konfliktet administrative dhe marrëdhëniet e punës, duke sjellë ngarkesë shtesë mbi fondet publike dhe duke kufizuar mundësinë e përdorimit të tyre për qëllime të tjera buxhetore. Këto veprime janë në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, pika 60. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 32-439, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Dibër dhe strukturat përgjegjëse të analizojnë në mënyrë periodike shkaqet që çojnë në humbjen e proceseve gjyqësore dhe krijimin e detyrimeve financiare ndaj institucionit, duke ndërmarrë masa parandaluese për reduktimin e rasteve të konflikteve administrative dhe të marrëdhënieve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, deri më datë 31.12.2024, detyrimet tatimore të papaguara nga subjektet e kategorisë biznes i vogël dhe biznes i madh arrinin në vlerën **16,383,076 lekë.** Gjatë vitit 2025, nga detyrimet e trashëguara deri më 31.12.2024, u arkëtua vlera **896,450 lekë,** ndërsa gjatë vitit 2025 u krijuan detyrime të reja në vlerën **1,401,130 lekë**. Për rrjedhojë, në datën 31.12.2025, detyrimet tatimore të papaguara rezultuan në vlerën **16,887,756 lekë.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dibër, si dhe nga testimi i rasteve të përzgjedhura të subjekteve debitore,

rezultoi se subjektet janë njoftuar dhe ri-njoftuar për shlyerjen e detyrimeve dhe, në raste të caktuara, janë ndërmarrë masa për bllokimin e llogarive bankare.
Megjithatë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga rastet e testuara, nuk rezulton të jetë dokumentuar në mënyrë të plotë analiza individuale e rasteve pas ndërmarrjes së masave të mësipërme, me qëllim përcaktimin e masave të mëtejshme që duhej të ndiqeshin sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë vlerësimin nëse, për ndonjë rast konkret, ishin plotësuar kushtet ligjore për referim pranë organeve kompetente.
Në kushtet kur detyrimet kanë vijuar të mbeten të papaguara, mungesa e dokumentimit të analizës dhe ndjekjes së mëtejshme të rasteve të debitorëve nuk siguron që procesi i mbledhjes së detyrimeve është ndjekur në mënyrë të plotë, sistematike dhe efektive.
Kjo situatë ka ndikuar në mosrealizimin e plotë të të ardhurave të veta vendore dhe në ruajtjen e një stoku të konsiderueshëm detyrimesh tatimore të papaguara, i cili më 31.12.2025 rezulton në vlerën **16,887,756 lekë.**
Veprimet dhe mosveprimet e konstatuara janë në kundërshtim me Ligjin nr. Nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Kreu XI, neni 88-96, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore" si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5., faqe 39-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër të marrë masa për forcimin e procedurave të administrimit dhe mbledhjes së detyrimeve tatimore, duke evidentuar për çdo subjekt debitor gjendjen e detyrimit, masat e ndërmarra, rezultatin e tyre dhe masat që duhet të ndiqen në vijim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Për subjektet debitore, për të cilat masat e ndërmarra nuk kanë rezultuar efektive, të kryhet analizë dhe dokumentim individual i rasteve, për të përcaktuar masat e mëtejshme që duhet të ndërmerren sipas kuadrit ligjor. Në rastet kur nga analiza dhe evidencat e administruara rezulton se janë plotësuar kushtet ligjore për referim penal, Bashkia të ndjekë procedurat përkatëse të referimit pranë organeve kompetente.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave dhe dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, në fund të vitit 2024, detyrimet debitore të abonentëve familjarë në qytetin e Dibrës dhe njësitë administrative përbënin vlerën **53,139,417 lekë**. Gjatë vitit 2025 janë krijuar detyrime të reja në vlerën **4,333,810 lekë**, duke bërë që detyrimi total progresiv i abonentëve familjarë, në datën **31.12.2025**, të arrijë në vlerën **57,473,227 lekë**.
Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht ekzistencës së detyrimeve debitore, nuk janë ndërmarrë në mënyrë të plotë dhe efektive masat e nevojshme për administrimin dhe mbledhjen e detyrimeve të papaguara, nëpërmjet procedurave të parashikuara nga legjislacioni tatimor për mbledhjen me forcë të detyrimeve.
Taksa e ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi i dokumentacionit të disponuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, përfshirë dokumentacionin lidhur me legalizimet e ndërtimeve informale dhe listat e administruara për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezultoi se detyrimi progresiv për këtë taksë, deri më **31.12.2025**, është në vlerën **4,360,122 lekë**.
Në mënyrë më të detajuar, gjendja e detyrimeve paraqitej me një gjendje debitore më 01.01.2025 në vlerën 3,287,903 lekë, detyrime të likuiduara gjatë vitit 2025 në vlerën 476,590 lekë dhe detyrime të krijuara gjatë vitit 2025 në vlerën 1,548,809 lekë.

Kjo situatë tregon për mangësi në procesin e administrimit, evidentimit dhe ndjekjes së detyrimeve të krijuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, si dhe për nevojën e forcimit të masave për identifikimin e debitorëve, njoftimin e tyre dhe arkëtimin e detyrimeve sipas procedurave ligjore në fuqi.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar**,** Kreu XI, "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 88–104; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar**,** neni 3, pikat 9 dhe 10**,** si dhe nenet 20–22**;** Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar**,** neni 9, pika 1.3.
Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se detyrimi tatimor në vlerën **57,473,227 lekë** nuk është pasqyruar dhe kontabilizuar në mënyrë të plotë në pasqyrat financiare të njësisë**,** duke mos reflektuar gjendjen reale të të drejtave financiare që njësia e vetëqeverisjes vendore ka ndaj abonentëve familjarë, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 32, sipas kërkesave të të cilit pasqyrat financiare duhet të paraqesin në mënyrë të plotë dhe të besueshme gjendjen financiare dhe të drejtat/detyrimet e njësisë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5., faqe 39-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dibër, të marrë masa për forcimin e administrimit të debitorëve, duke kryer për çdo subjekt/abonent debitor analizën e gjendjes së detyrimit, periudhës së krijimit, pagesave të kryera, masave të ndërmarra dhe masave që duhet të ndiqen në vijim.
Për rastet e testuara dhe për debitorët me detyrime të papaguara, të dokumentohen në mënyrë të plotë njoftimi, kërkesa për pagesë dhe masat e tjera të parashikuara nga legjislacioni, sipas kushteve konkrete të çdo rasti.
Gjithashtu, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dibër, të kryejë rakordimin e regjistrit të debitorëve me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, të evidentojë diferencat dhe, pas verifikimit të dokumentacionit, të kryejë sistemimet kontabël përkatëse, me qëllim që të drejtat financiare ndaj debitorëve të paraqiten në mënyrë të plotë dhe të saktë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Referuar gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna nga ana e grupit të auditimit si dhe mbështetur në nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në VKM-në nr.115, datë 05.03.2014"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" si dhe Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dibër**, për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi dhe me shkelje në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave përkatëse disiplinore.
Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT